



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit me karakter profesional në

“Teknikë Elektrike”

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Aida Spahiu

2. Dr. Lindita Dhamo

Mars/ 2024

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për programin e studimit me karakter profesional në “Teknikë Elektrike” ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program studimi me karakter profesional në “Teknikë Elektrike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASH Nr. 371, datë 05.09.2013
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	- Shkresë MASR Nr 7239/1, datë 17.08.2018 - Shkresën MAS Nr. 2085/1 Prot., datë 27.06.2022
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 325, datë 22.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	5 PAE/ 1 PAK
18	Numri i studentëve:	116 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit 2-vjeçar me karakter profesional në “Teknikë Elektrike” është një program studimi i ofruar nga Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë, njësi bazë e Fakultetit të Studimeve Profesionale, në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, UAMD.

Ky program është hapur për herë të parë me emërtimin “Specialist Elektrik”, në vitin akademik 2023-2014 me Urdhër i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me Nr. 371, datë 05.09.2013.

Programi është riorganizuar deri në masën 20% për shkak të ndryshimeve në legjislacionin për Arsimin e Lartë në vendin tonë, duke filluar me propozimin e Departamentit, me Vendim Senati Akademik të UAMD me Nr. 86, datë 14.06.2018, miratuar nga MASR me shkresë Nr 7239/1, datë 17.08.2018. Në këto dokumente zyrtare emërtimi i programit të studimit profesional është “Teknikë Elektrike” dhe jo më “Specialist Elektrik”. Këto ndryshime në program dhe emërtim janë reflektuar për vitin akademik 2028-2019.


Programi i studimit është riorganizuar nën 20% dhe në vitin akademik 2022-2023 me Vendimin e Senatit Akademik të UAMD Nr. 18, datë 28.03.2022, ndryshime për të cilat është njoftuar MASR dhe ka konfirmuar marrjen e njoftimit me shkresën Nr. 2085/1 Prot., datë 27.06.2022.

Programi i studimit dy-vjeçar me karakter profesional në “Teknikë Elektrike” realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, dhe me kohëzgjatje normale.

Programi i studimit dy-vjeçar me karakter profesional në “Teknikë Elektrike”, realizohet në dy vite akademik, me 4 semestra dhe në përfundim të këtij programi studimi me karakter profesional lëshohet “Diplomë Profesionale”. Diploma e këtij programi studimi është e regjistruar në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor me Urdhër të Qendrës së Shërbimeve Arsimore, QSHA, Nr. 325, datë datë 22.10.2020.

Programi i studimit me karakter profesional “Teknikë Elektrike”, është një program studimi i nivelit 5 referuar Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Ky është akreditimi i parë për këtë program studimi me karakter profesional në “Teknikë Elektrike”.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit profesional në “Teknikë Elektrike” të ofruar nga Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë, njësi bazë e Fakultetit të Studimeve Profesionale, në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, UAMD, filloi me prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm.

Grupi, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, shqyrtoi Raportin e vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë gjetjesh që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, GVJ në dakortësi edhe Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, realizoi takimet e përcaktuara në axhendën e vizitës fizike në IAL, në datën 6 Dhjetor 2023.

Në këtë vizitë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua sipas axhendës të përcaktuar më parë dhe të dakortësuar me UAMD në takime të veçanta me: Dekanin dhe Zv Dekanen, e cila është dhe anëtare e Departamentit që ofron programin e studimit, Grupin e vlerësimit të brendshëm, stafin akademik të programit të studimit, Drejtorinë së kurrikulës dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, sekretarinë mësimore, Sektorin e planifikimit dhe monitorimit të projekteve, intervistë me studentët, vëzhgimi i mjediseve të institucionit si: auditorë, laboratorë, biblioteka etj.

Gjatë takimeve u bënë pyetje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe elementë të veçantë.

Më datë 29.02.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 19/47 Prot., datë 29.02.2024, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.


Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës kthehu përgjigje në sistemin AMS më datë 18.03.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr. 476/1, datë 19.03.2024.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.

Vlerësimi i programit të studimit me karakter profesional në “Teknikë Elektrik”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, UAMD, si Institucion publik i Arsimit të Lartë, ofron programe studimi, të cilat nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Në statutin e UAMD shprehet qartë se mbështetet në Kushtetutën e Shqipërisë dhe Ligjin për Arsimin e Lartë LAL 80/2015 (Evidencë.18 – Statuti UAMD, neni 2). Misioni i UAMD është: a) të krijojë, të zhvillojë e të përcjellë dijet përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si edhe të nxisë e të zhvilloj artet, edukimin fizik dhe sportet; b) të formojë specialist të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj; c) të përgatisë profesionistë e qytetarë aktivë për shoqërinë demokratike shqiptare dhe për vlerat evropiane; etj. (Evidencë.18 – Statuti UAMD, neni 3)
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit me karakter profesional “Teknikë Elektrike” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë, të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.	Programi i studimit me karakter profesional “Teknikë Elektrike” është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së UAMD si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij. UAMD ofron programe të studimeve me karakter profesional, niveli 5 sipas komizës së kualifikimeve shqiptare, të shprehura qartë në statutin dhe rregulloren e tij (Evidencë.18 – Statuti UAMD, neni 58, 59 dhe Evidencë.19 – Rregullore UAMD, neni 42). Programet e studimit të ofruara janë bashkëkohore, në përputhje me nevojat e tregut të punës, të territorit, të shoqërisë dhe të studentit, pasi përcaktimi i fushave prioritare të studimit janë të identifikuara në interes të zhvillimit rajonal e kombëtar (Evidencë.16 – Plani i zhvillimit strategjik UAMD, f. 6).
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi	Në dokumentacionin e vendosur në sistem ka material të përgjithshëm mbi tregun lokal dhe kombëtar të punësimit për këtë program studimi profesional me qëllim argumentimin e ndryshimeve në kurrikul për

tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.	vitin akademik 2022-2023 (Evidencë. 21 – Studim). Në dokumentacionin e vënë në sistem mungon studimi i tregut për hartimin e këtij programi studimi. Në sistem janë vendosur dhe studime të përgjithsme nga shoqata apo Konferenca në lidhje me tregune punës në përgjithësi në Shqipëri (Evidencë.118 – Studim tregu për degën TE).
Kriteri 5. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	UAMD ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit të studimi me karakter profesional në “Teknikë Elektrike”. UAMD përbëhet nga 5 fakultete. Fakulteti i Studimeve Profesionale, që mbështet këtë program studimi është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 801, datë 20.12.2006, si një nga njësitë kryesore të Universitetit “Aleksandër Moisiu” (UAMD). Fillimisht njihet si Shkollë e Lartë Profesionale. Që nga viti 2010 ka ndryshuar status në “Fakultet i Studimeve Profesionale”, FSP. FSP përbëhet nga 4 Departamente dhe ky program studimi mbështetet nga Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë. FSP ka katër Departamente me 42 – personel akademik efektiv, PAE ku 23 prej tyre janë me grada shkencore dhe tituj akademik. FSP ka 117 – personel akademik me kontratë, PAK, ku 37 prej tyre janë me grada shkencore dhe tituj akademik (Evidencë.22 – Personeli i 4 Dep. FSP). FSP ofron programe të ndryshme të arsimit profesional si: Teknikë Elektrike, Teknologji Automobilash, Menaxhim Transporti Detar/Tokësor, Menaxhim Ndërtimi, Hidroteknikë Ujësjellës Kanalizime, Mekanikë Detare, Mekanikë Impiante Industriale e Bujqësore, Specialist i Sistemeve të Kondicionimit, Ndihmës Dentist, Asistent Administrativ, Asistent Ligjor, Informatikë Praktike, Specialist Rrjetash Kompjuterike dhe synon krijimin e një sistemi modern dhe cilësor të arsimit profesional në vend (Evidencë.118 – Studim tregu për degën TE). Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë, DSHID, i cili mbështet këtë program studimi, ka 14 PAE, ku 5 prej tyre janë me grada shkencore dhe tituj akademik dhe 30 PAK, ku 5 prej tyre janë me grada shkencore dhe tituj akademik (Evidencë.24 – Personeli DSHID).
Kriteri 6. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit me karakter profesional “Teknikë Elektrike” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore dhe bazë që ofron këtë program studimi. FSP ofron programe të ndryshme të arsimit profesional pas arsimit të mesëm FSP. (Evidencë.26 – Rregullore FSP). Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë, DSHID, ofron programe të ndryshme të arsimit profesional pas arsimit të mesëm FSP (Evidencë.27 – Rregullore DSHID). Kodifikimi për këtë program studimi është dhënë UAMD-DIP-50713-ELEK në (Evidencë.47 – Kodifikimi i programeve) por nuk është i duhuri. Mbështetur në përcaktimet të VKM nr.310 datë 11.05.2022

	kodi i duhur për këtë program studimi është: 52PP0713S			
Konkluzione	Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, UAMD, si Institucion publik i Arsimit të Lartë, ofron programe studimi, të cilat nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Programi i studimit me karakter profesional "Teknikë Elektrike" është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës. Programi i studimit me karakter profesional "Teknikë Elektrike" është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së UAMD si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij. UAMD ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit të studimit me karakter profesional në "Teknikë Elektrike". Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit me karakter profesional "Teknikë Elektrike" është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore dhe bazë që ofron këtë program studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	UAMD ka siguruar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit me karakter profesional "Teknikë Elektrike" (Evidencë.26 – Rregullore FSP, neni 13, 14; Evidencë.27 – Rregullore DSHID, neni 15, 17, 18; Evidencë.39 – politikat hapje /riorganizim prog. Studimi; Evidencë.48 – Shtojca 1- Riorganizimi TE).
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni	UAMD ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve si: Fakulteti i Shkencave

vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Teknike, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë; Universitetin "Luarasi"; Kolegjin Profesional të Tiranë; Universty of Foggia, Italy, Kolegji Universitar "CEPS-CENTER Businlrccs studies" Kiseljak, Bosnje-Hercegovina; Akademinë Detare të Lituanisë; Universitetin e Prishtinës, Kosovë. <i>GVJ vëren se marrëveshja me Universitetin e Vlorës ka përfunduar në nëntor 2022, ndërsa për dy marrëveshjet e tjera mungon marrëveshja.</i> (Evidencë.29 – Marrëveshje FSP). <i>GVJ vëren se marrëveshja me Universitetin e Foggias, Itali ka përfunduar në 2023, ndërsa për marrëveshjet e tjera mungon marrëveshja.</i> (Evidencë.62 – Marrëveshje me Universitetet jashtë vendit). UAMD ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi aktorët e biznesit vendës për këtë program studimi (Evidencat 31-37)
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.	GVJ konstaton se UAMD ka institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale (Evidencat 31-38). Evidenca 38 tregon për bashkëpunimin me kompanitë për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<i>GVJ konstaton se në materialet e vëna në sistem mungojnë raporte analitike nga DSID të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit me karakter profesional "Teknikë Elektrik".</i>
Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	GVJ konstaton se se në materialet e vëna në sistem mungon paraqitja e iniciativave specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.
Konkluzione	<i>UAMD ka siguruar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit me karakter profesional "Teknikë Elektrike".</i> <i>GVJ vëren se disa marrëveshje kanë përfunduar dhe për disa të tjera mungon marrëveshja.</i> <i>GVJ konstaton se në materialet e vëna në sistem mungojnë raporte analitike nga DSID të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit me karakter profesional "Teknikë Elektrik".</i>

	GVJ konstaton se se në materialet e vëna në sistem mungon paraqitja e iniciativave specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UAMD ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Në nivel Institucional strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë janë: - Senati Akademik - Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC) (Evidencat 40- Organigrama UAMD). - Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC) - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për FSP (Evidencat 43 – Komisioni i cilësisë FSP). UAMD ka “Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë” (Evidencat 42 – rregullore e sigurimit të brendshëm të cilësisë).
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	UAMD ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. Informacion i plotë për funksionimin e Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë jepet në “Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë” (Evidencat 42 – rregullore e sigurimit të brendshëm të cilësisë). Në përbërje e NJSBC për FSP ka një student. (Evidencat 43 – Komisioni i cilësisë FSP). GVJ nga materialet e vëna në sistem nuk konstatoi përfshirjen e ekspertëve të jashtëm për vlerësimin e cilësisë së këtij programi studimi.
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e	UAMD përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. FSP, e cila mbështet këtë program studimi, bën raportim vjetor të brendshëm në lidhje me cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor për të siguruar cilësinë e programit të studimit

lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	(Evidencat 43). FSP ka caktuar koordinatorët e programeve të studimit, për programet që mbështet. Koordinatori i programit ka një rol kyç në sigurimin e cilësisë së programeve akademike në UAMD dhe siguron garantimin e suksesit të studentëve në universitet (Evidencat 44 – Koordinatorët Vendim DSID; Evidenca 28 – Rregullore e programit të studimit TE, neni 12). Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.	UAMD përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. GVJ konstaton se FSP organizon takime të hapura me studentët me qëllim mbledhjen e shqetësimeve dhe problematikave që kanë për ti përmirësuar dhe zgjidhur problematikën e tyre, për mësimdhënien, praktikën mësimore, ambientet etj, anketimet e studentëve, raportet e kerkimit shkencor dhe mesimdhënies nga pedagogët, raporti vjetor i brendshëm i FSP etj. (Evidencat 45, 66, 68, 69, 75, 111, 115). UAMD duhet të bënte promovime nxitëse për të evidentuar dhe promovuar arritjet më të mira të personelit akademik.			
Konkluzione	<i>UAMD ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</i> <i>Në përbërje e NJSBC për FSP ka një student</i> <i>GVJ nga materialet e vëna në sistem nuk konstatoi përfshirjen e ekspertëve të jashtëm për vlerësimin e cilësisë së këtij programi studimi.</i> <i>UAMD përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale.</i> <i>UAMD duhet të bënte promovime nxitëse për të evidentuar dhe promovuar arritjet më të mira të personelit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit me karakter profesional “Teknikë Elektrike” është i organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Elementet e programit të studimit janë në përputhje të plotë me VKM 879, datë 18.12.2019, Shtojca 1, tabela 1.1. A- LËNDË BAZË – 15% kërkohet (10% - 15%) kredite. B- LËNDË KARAKTERIZUESE – 53% kërkohet (45% - 55%) kredite. C- LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – 13% kërkohet (5% - 5%) kredite. D- LËNDË PLOTËSUESE – 13% kërkohet (10% - 15%) kredite. E- DETYRIME PËRMBYLLËSE – 5% kërkohet (3% - 5%) kredite. (Evidencat 124 – Tabela e veprimtarive formuese)
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.	Programi i studimit me karakter profesional “Teknikë Elektrike” synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës. Në këtë program studimi zhvillohen lëndë bazë të profesionit si Elektroteknikë, Elektronikë, Matje elektrike, Makina elektrike etj. Në këtë program studimi zhvillohen dhe lëndë të tjera karakterizuese, të cilat ndihmojnë për zhvillimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të përparuara në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale si: Automatizim, Impjante Elektrike, Burimet e rinovueshme të energjisë (Evidencat 124 – Tabela e veprimtarive formuese). GVJ konstaton se do të ishte me interes të përfshiheshin dhe lëndë të softeve që përdoren në sektorin e energjisë duke patur parasysh se jemi në kohën e tranzicionit green dhe dixhital.
Kriteri 3. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të	Programi i studimit me karakter profesional “Teknikë Elektrike” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të

studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.	fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit. Në rregulloren e programit të studimit, neni 6 shprehen qartë misioni dhe objektivat e programit të studimit (Evidencat 28 – Rregullore e programit TE): a) Përgatitja e specialistëve me kualifikim sa më bashkëkohor në fushën e elektrike; në sisteme prodhimit të energjisë elektrike në centralët elektrike; në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike; në sistemin e shpërndarjes të energjisë elektrike, në sektorin publik e privat. b) Të përgatisë specialistë me kualifikim sa më bashkëkohor të njohurive teknike specifike për Drejtues teknik, dispeçer (në hidrocentrale të Koorporatës Elektroenergjitike Shqiptare, në nënstacione të OST dhe OSSH, në sektor privat etj), për firmat projektuese dhe zbatuese të ndryshme elektrike, shoqëri të ndryshme për aplikime të menaxhimit të energjisë elektrike në tregun e energjisë elektrike, në impiantet industriale, në sistemin urban dhe rural, drejtoritë rajonale të energjisë. c) Përgatitja e specialistëve të aftë në ofrimin e instalimeve elektrike dhe mirëmbajtjen e tyre në banesa, objekte të ndryshme të sektorit privat dhe atij publik, në aktivitete teknike dhe drejtuese në kompani për projektimin, realizimin dhe servisin e sistemeve të fuqisë me tension të lartë, të mesëm dhe të ulët si dhe në prodhimin e aparateve dhe pajisjeve elektrike.
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/ modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit me karakter profesional “Teknikë Elektrike” ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/ modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Programi i studimit ka 16 kredite për realizimin e praktikës profesionale, 8 kredite në vitin e parë dhe 8 kredite në vitin e dytë. Programi i studimit mbyllet me mbrojtjen e diplomës, e cila ka 6 kredite (Evidencat 127 – Planet mësimore dega TE v 2020-2024).
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadër ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	UAMD është IAL publike dhe nuk është në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë (Evidencat 2, 12, 46).
Kriteri 6. Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën	Programi i studimit me karakter profesional “Teknikë Elektrike”, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.

emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	GVJ konstaton se GVB duhet të kishte vënë dokumente në sistem për të treguar se ky program studimi ka paku 70% përmbajtje të ngjashme me programe të njëjta me karakter profesional që zhvillon Kolegji Profesional i Tiranës, KPT, IKUB etj.			
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Procesi i kodifikimit për këtë program studimi ashtu si dhe për programet e tjera është në proces. UAMD ka dërguar shkresë MAS për kodifikimin e këtij programi studimi, për të cilin GVJ konstatoin se nuk është i duhuri (Evidenca 49 – Kodifikimi i programeve). Mbështetur në përcaktimeve të VKM nr.310 datë 11.05.2022 kodi i duhur për këtë program studimi është: 52PP0713S			
Konkluzione	Programi i studimit me karakter profesional "Teknikë Elektrike" është i organizuara në lëndë e module. Programi i studimit me karakter profesional "Teknikë Elektrike" synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës. GVJ konstaton se do të ishte me interes të përfshiheshin dhe lëndë të softeve që përdoren në sektorin e energjisë duke patur parasysh se jemi në kohën e tranzicionit green dhe dixhital. Programi i studimit me karakter profesional "Teknikë Elektrike" ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. GVJ konstaton se GVB duhet të kishte vënë dokumente në sistem për të treguar se ky program studimi ka paku 70% përmbajtje të ngjashme me programe të njëjta me karakter profesional që zhvillon Kolegji Profesional i Tiranës, KPT, IKUB etj. Mbështetur në përcaktimeve të VKM nr.310 datë 11.05.2022 kodi i duhur për këtë program studimi është: 52PP0713S.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Standardi II.2				
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.				
Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në	FSP njësia kryesore, e cila ofron këtë program studimi përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. FSP është e organizuar me katër Departamente, ku tre prej tyre kanë			





fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	mbi 7 PAE në Departament dhe Departamenti i Studimeve të Integruara me Praktikën ka 4 PAE. Tre Departamentet me mbi 7 anëtare kanë mbi 3 PAE me gradë shkencore dhe tituj akademik (Evidenca 22 – Personeli 4 Dep. FSP). DSID, njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. DSID ka 14 PAE ku 5 me grada shkencore dhe tituj akademik ndërsa personeli tjetër akademik i këtij Departamenti është me diplomë Master i Shkencave (Evidenca 24 – Personeli DSID-kualifikimi). Për këtë program studimi mjafton që personeli të ketë diplomë Master Profesional (Evidenca 12 – LAL 80/2015).			
Kriteri 2. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik/ administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	<i>GVJ konstaton se FSP njësia kryesore dhe DSID njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit nuk kanë personel ndihmës akademik për të ndjekur praktikat për këtë program studimi FSP ka 5 laborant, por asnjë të profilizuar për këtë program studimi.</i> (Evidenca 22 – Personeli 4 Dep. FSP). Praktika mësimore për këtë program studimi, duke qenë se njihet si ngarkesë mësimore suplementare jashtë auditorit për personelin akademik, Udhëzimi 29, datë 10/09/2018, i ndryshuar realizohet nga PAE në këtë Departament. (Evidenca 132 – Tabela titullar-pedagog lënde).			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	FSP, Njësia kryesore dhe DSID njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi kanë caktuar një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. (Evidenca 44 – Koordinatorët – Vendimi DSID; Evidenca 59 – Vendimi DSID – pedagogët mentor).			
Konkluzione	<i>FSP njësia kryesore, e cila ofron këtë program studimi përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</i> <i>GVJ konstaton se FSP njësia kryesore dhe DSID njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit nuk kanë personel ndihmës akademik për të ndjekur praktikat për këtë program studimi FSP ka 5 laborant, por asnjë të profilizuar për këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	FSP si njësia kryesore dhe DSID si njësi bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të shprehura në Rregulloret e njësive kryesore, njësive bazë dhe rregulloren e programit të studimit, Kreu III Organizimi i studimeve në programin 2-Vjeçar “Teknikë Elektrike”, neni 21: Struktura e programit të studimit “Teknikë Elektrike”. (Evidenca 26, 27, 28)
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/ moduleve në kredite, orët në auditor/ jashtë auditorit.	Programi i studimit me karakter profesional “Teknikë Elektrike” përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/ moduleve në kredite, orët në auditor/ jashtë auditorit. (Evidenca 127 – Planet mësimore, dega TE, v.2020-2024).
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit me karakter profesional “Teknikë Elektrike” përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, të shprehura qartë në Rregulloren e programit të studimit, Kreu Iii Organizimi i studimeve në programin 2-Vjeçar “Teknikë Elektrike”, neni 22-24, 26. (Evidenca 28 – Rregullore e programit TE)
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikë, seminar apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit me karakter profesional “Teknikë Elektrike” përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikë, seminar apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me shtojcën e miratuar nga VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, Shtojca 3. <i>GVJ konstaton se literature në disa lëndë duhet përditësuar si në lëndë bazë “Elektroteknikë”, “Sistemet elektrike në ndërtesa”. Gjithashtu për të gjitha lëndët nuk jepet viti i botimit të literaturës bazë të rekomanduar.</i> Syllabusi për lëndën “Normativat në punimet elektrike” mungon. Literatura për lëndën Matje elektrike mungon. (Evidenca 126 – Syllabuset TE).
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në	Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë. Kjo tregohet qartë në riorganizimet që ka pësuar programi i studimit në vitin 2018 dhe në vitin 2020, për të cilat është njoftuar dhe

njësine bazë.	Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë. (Evidenca 4-9)			
Konkluzione	<i>FSP si njësi kryesore dhe DSID si njësi bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</i> <i>Programi i studimit me karakter profesional "Teknikë Elektrike" përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/fjashtë auditorit.</i> <i>GVJ konstaton se literature në disa lëndë duhet përditësuar si në lëndë bazë "Elektroteknikë", "Sistemet elektrike në ndërtesa". Gjithashtu për të gjitha lëndët nuk jepet viti i botimit të literaturës bazë të rekomanduar.</i> <i>Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësine bazë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.	Emërtimi i programit të studimit me karakter profesional "Teknikë Elektrike", përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve. (Evidenca 126 – Syllabuset TE).
Kriteri 2. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore i programit të studimit me karakter profesional "Teknikë Elektrike" mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit (Evidenca 127 – Planet mësimore, dega TE, v.2020-2024).

Kriteri 3. Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/ aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/ punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.

Programi i studimit me karakter profesional “Teknikë Elektrike” ka një raport të balancuar midis moduleve/ aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre, praktike (50:50), siç tregohet qartë në tabelën e mëposhtme.

Viti/Semestri	Leksion (kredite)	Seminar (kredite)	Laborator (kredite)	Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave Lëndore në auditor. Praktikë Profesionale (kredite)
Viti 1/Sem.1	16	10	3	1
Viti 1/Sem.2	11	7	1	12
Viti 2/Sem.1	15	13	1.5	0.5
Viti 2/Sem.2	8	7	0	9
Total	50	37	5.5	22.5

Rreth 24.5% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/ punë konkrete në profesion. Në këtë % është marrë në konsideratë numri i krediteve Laborator + Praktikë profesionale dhe lëndore 28 Kredite/ 114 kredite (pa diplomën).

GVJ konstaton se në planin mësimor për këtë program studimi duhet të rritet numri i krediteve për laboratorët, që janë shumë të rëndësishëm për këtë program studimi me karakter profesional, si për shembull në lëndët Elektroteknikë, Matje elektrike, Makina elektrike.

Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.

(Evidenca 127 – Planet mësimore, dega TE, v.2020-2024).

Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.

Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik për këtë program studimi mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve brenda të njëjtit cikël studimi, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.

(Evidenca 127 – Planet mësimore, dega TE, v.2020-2024).

Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për

GVJ konstaton se syllabuset kanë të përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse por kjo literaturë nuk është e përditësuar.

marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.	Në dokumentacionin e vënë në sistem nuk jepet ndonjë informacion mbi përditësimin e syllabuseve në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. (Evidenca 126 – Syllabuset TE).			
Kriteri 6. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/ përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.	Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/ përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit për këtë program studimi. Në rregulloren e programit të studimit neni 42, jepet në mënyrë të detajuar se si do të zhvillohet praktika profesionale. (Evidenca 28 – rregullore TE). Për programin e studimit ka një set formularësh për vlerësimin e saj dhe bashkëpunimin me punëdhënësit. (Evidenca 38–Udhëzues praktike+anekset).			
Kriteri 7. Përbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.	Përbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK. GVJ rekomandon futje e një lënde programimi e cila do të ndihmonte në rritjen e aftësive dixhitale të studentëve ose futjen në modele të aftësive dixhitale në lëndë të ndryshme.			
Konkluzione	<i>Emërtimi i programit të studimit me karakter profesional “Teknikë Elektrike”, përbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.</i> <i>GVJ konstaton se në planin mësimor për këtë program studimi duhet të rritet numri i krediteve për laboratorët, që janë shumë të rëndësishëm për këtë program studimi me karakter profesional, si për shembull në lëndët Elektroteknikë, Matje elektrike, Makina elektrike.</i> <i>Në dokumentacionin e vënë në sistem nuk jepet ndonjë informacion mbi përditësimin e syllabuseve në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i> <i>GVJ rekomandon futje e një lënde programimi, e cila do të ndihmonte në rritjen e aftësive dixhitale të studentëve ose futjen në modele të aftësive dixhitale në lëndë të ndryshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423


Web site: www.ascal.al

Faqe 18

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	UAMD ka strategji komunikimi, me anë të së cilës synon të mundësojë ndërtimin e urave të reja të komunikimit e shpërndarjen e informacionit në mënyrë sa më efektive me institucionet qendrore dhe lokale, organizata dhe institucione akademike kombëtare dhe ndërkombëtare, shoqërinë civile, por edhe partnerë të tjerë të mundshëm. (Evidenca 54 – Strategji komunikimi UAMD). GVJ në dokumentacionin e vënë në sistem nuk gjeti ndonjë eksperiencë konsultimi me institucionet partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës për ecurinë e programit të studimit me karakter profesional për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit. Përmirësimi i programit të studimit është bërë për tju përshtatur ndryshimeve ligjore që ka pësuar kuadri ligjor në fuqi për arsimin e lartë. (Evidenca 5 – V. Senati 86, 14.06.2018 Riorganizim TE).
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	UAMD nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, kur ato janë pjesë e programit të studimit por kjo nuk vazhdon me studentët e diplomuar të këtij programi studimi dhe që janë pjesë e tregut të punës. (Evidenca 115 – Praktika për mentorim). Kontaktet dhe konsultimet e vazhdueshme me studentët e diplomuar, do të ndihmonte UAMD për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin e tyre kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë dhe institucione publike e private.	DSID ka përmirësuar, përditësuar dhe përshtatur programin e studimit në vite por GVJ në dokumentacionin e vënë në sistem nuk gjeti ndonjë bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë dhe institucione publike e private për këtë program studimi në drejtim të përmirësimit të tij.
Konkluzione	GVJ në dokumentacionin e vënë në sistem nuk gjeti ndonjë eksperiencë konsultimi me institucionet partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës për ecurinë e programit të studimit me karakter profesional për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit. UAMD nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, kur ato janë pjesë e programit të studimit por kjo nuk vazhdon me studentët e diplomuar të këtij programi studimi dhe që janë pjesë e tregut të punës. DSID ka përmirësuar, përditësuar dhe përshtatur programin e studimit në vite por GVJ në dokumentacionin e vënë në sistem nuk

	<i>gjeti ndonjë bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale dhe institucione publike e private për këtë program studimi në drejtim të përmirësimit të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi															
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Vërejmë se në nivel institucional, UAMD, ka miratuar rregullore dhe udhëzues dhe organizon trajnime të vazhdueshme për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve. Format e mësimdhënies janë të ndara sipas aktiviteteve specifike si leksione, seminare, laboratorë, provime, detyra kursi etj. Gjithashtu, bazuar edhe në rregulloren e programit të studimit, studentët duhet të frekuentojnë të paktën 75 % të orëve të leksioneve e seminareve dhe 100% të orëve laboratorike/ praktike në terren që të lejohen të marrin pjesë në provimin përfundimtar të lëndës. GVJ konstaton se në planin mësimor të paraqitur nga GVB, rezultojnë se 1255/3000 orë zhvillohen në auditor të ndara në aktivitetet si më poshtë vijon: <table><tr><td>1255</td><td>42%</td><td>orë auditor/ orë totale</td></tr><tr><td>1745</td><td>58%</td><td>orë studimi individual/ orë totale</td></tr><tr><td>632</td><td>50%</td><td>(Leksion+Praktikë Lëndore)/ orë auditor</td></tr><tr><td>623</td><td>50%</td><td>(Seminar + Lab. + Praktikë prof.)/ orë në auditor</td></tr><tr><td>312</td><td>25%</td><td>(Praktikë prof/ + Praktikë lëndore)/ orët në auditor</td></tr></table> Leksionet e hapura, debatet me ekspertë të ftuar të njohur, diskutimet me aktorët e tregut të punës si dhe forumet profesionale dhe në nivel studentor janë pjesë e formave të mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve. [EVIDENCA nr. 124 “Plani mësimor dhe Tabela e veprimtarive formuese të programit të studimit “Teknikë Elektrike” EVIDENCA nr. 125 “Tabelat e ngarkesës totale në auditor për format e mësimdhënies dhe format e kontrollit të njohurive në programin e studimit 2-vjeçar “Teknikë Elektrike”	1255	42%	orë auditor/ orë totale	1745	58%	orë studimi individual/ orë totale	632	50%	(Leksion+Praktikë Lëndore)/ orë auditor	623	50%	(Seminar + Lab. + Praktikë prof.)/ orë në auditor	312	25%	(Praktikë prof/ + Praktikë lëndore)/ orët në auditor
1255	42%	orë auditor/ orë totale														
1745	58%	orë studimi individual/ orë totale														
632	50%	(Leksion+Praktikë Lëndore)/ orë auditor														
623	50%	(Seminar + Lab. + Praktikë prof.)/ orë në auditor														
312	25%	(Praktikë prof/ + Praktikë lëndore)/ orët në auditor														
Kriteri 2. Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në programin mësimor dhe syllabusët e lëndëve janë të parashikuara forma e metoda alternative të mësimdhënies dhe mësimnxënies duke ju përshtatur fushës dhe natyrës së lëndëve specifike të programit të studimit, leksion, seminare, laboratorë, projekte, praktika profesionale, si dhe aktivitete dhe pjesëmarrjes në projekte të shkëmbimit studentor Erasmus etj.. Të gjitha materialet mësimore gjenden në formën klasike si: libra fizik në bibliotekë, literaturë elektronike si dhe materiale të lëndës të ofruara nga pedagogu nëpërmjet platformës elektronike në përdorim nga UAMD. Gjithashtu, institucioni ka përdorur me sukses edhe platformat online të përcimit të dijeve, sidomos gjatë periudhës së diktuar nga përhapja e															

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.asc.al

Faqe 21




	pandemisë Sars-Cov2. Personeli akademik është i mirë përparësuar dhe përdor metoda dhe teknika të ndryshme inovative të përshqarë sipas natyrës dhe programit të lëndëve duke alternuar pjesën teorike me ato praktike në laboratorët e institucionit. [Evidenca 19 Rregullorja UAMD], [Evidenca 28 Rregullorja e programit të studimit TE], [Evidenca 87 Manual Biblioteka online]
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.	Nga DVV dhe vizita në zyrën e burimeve njerëzore GVJ konstaton se Institucioni rekruton staf akademik të kualifikuar dhe kompetent në fushën e tij të ekspertizës profesionale. Gjithashtu, janë organizuar programe trajnimi të strukturuar (seminare dhe workshope lidhur me mësimdhënien, kërkimin shkencor, projektet etj.) në nivel institucioni, brenda dhe jashtë vendit, ku stafi akademik përfshihet në programet e shkëmbimit të stafit me Universitetet e tjera partnere me të cilat ka marrëveshje (Erasmus +). DSID mbështet stafin e tij akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura, workshope si dhe trajnime specifike në kuadër të moduleve specifike teorike, laboratorike dhe praktike. [EVIDENCA nr. 62 "Marrëveshje e lidhur me UAMD dhe Universitetin Foggia, Itali, Marrëveshje e lidhur me UAMD dhe Kolegjin Universitar "CEPS-CENTER for bussinnes studies" Kisellak, Bosnje; Marrëveshje e lidhur me UAMD dhe Akademisë Detare të Lituanisë; Marrëveshje e lidhur me UAMD dhe Universitetin të Prishtinës, Kosovë" EVIDENCA nr. 63 "Informacion nga Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhëniet me Jashtë për mobilitetet e personelit akademik" EVIDENCA nr. 130 "Tabelë përmbledhëse e aktivitetit shkencor dhe evidencat e veprimtarisë shkencore të personelit akademik të DSID për vitet 2014-2019-2021" EVIDENCA nr. 65 "Informacion mbi angazhimin në projekte"]
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik të student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë me tyre.	Personeli akademik transmeton njohuritë dhe konceptet e lëndës të studentit duke konkretizuar ato dhe me raste konkrete të eksperiencave profesionale të tyre. Kjo pasi Personeli akademik angazhohet në mësimdhënie përmes një procesi dinamik të vlerësimit të njohurive, kompetencave dhe metodologjisë në mësimdhënie dhe, se shpërndarja e lëndëve të programit tek stafi akademik realizohet duke u bazuar në fushat e eksperiencës së tyre. Ndihmon këtu edhe angazhimi në projekte të ndryshme, trajnimi i vazhdueshëm etj. [Evidenca 25 Cv stafi akademik efektiv TE],
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit,	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit me

vlërëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	karakter profesional “Teknikë Elektrikë” vlerëson dhe përmirëson format dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë të vazhdueshme, në të cilën mbështetet nga infrastruktura e vënë në dispozicion, trajnime dhe pjesëmarrje në projekte e shkëmbimit të eksperiencës me institucione akademike në vend dhe jashtë. Studentët përfshihen në këtë proces gjatë zhvillimit të lëndës në komunikim dhe konsultim direkt me pedagogun e lëndës në platformat inovative në përdorim në IAL dhe në procesin e vlerësimit të mësimdhënies. Gjatë vizitës në IAL, nga takimi dhe komunikimi me studentët pjesëmarrës të programit të studimit me karakter Profesional në “Teknikë Elektrikë”, rezultoi se ishin të kënaqur nga infrastruktura dhe metodat e përdorura në mësimdhënie nga personeli akademik dhe në sistemin online. [EVIDENCA nr. 66 “Rezultatet e anketimit të studentëve, stafit dhe administratës mbi institucionin”], [Evidenca 133 Raporti vjetor DSID 2019-2021]			
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL në zbatim të kërkesave ligjore në shërbim të sigurimit të cilësisë në institucion ka vënë në funksion struktura në nivel institucional si Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) që është njësia kryesore, një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të institucionit. Një ndër detyrat e kësaj strukture është të vlerësojë periodikisht veprimtaritë e mësimdhënies si dhe ato të kërkimit shkencor. Gjithashtu, Zyra e Standardeve dhe Cilësisë kujdeset që kuadri rregullator i IAL të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Organizimi dhe funksionimi i këtyre strukturave është përcaktuar në statutin e UAMD dhe dokumentin e funksionimit të NJSBC dhe manualit të sigurimit të cilësisë të institucionit. UAMD ka hartuar strategjinë dhe planin e veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë, ku jepen politikat e objektivave kryesore dhe standardet e sistemit të menaxhimit të cilësisë në përdorim në IAL. Përveç këtyre strukturat drejtuese janë gjithashtu përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë. [Evidenca 18 Statuti i UAMD], [Evidenca 19 Rregullorja UAMD], [Evidenca 42 Rregullorja NJSBC], [Evidenca 75 Formularët e vlerësimit pedagogëve],			
Konkluzione	<i>UAMD, në angazhimin e mësimdhënies, ka plotësuar bazën laboratorike me module dhe makete gjithëpërfshirëse në fushën e zbatimeve elektrike . Kjo mundëson një proces transferimi të njohurive efikase tek studentët dhe rrit rezultatet e tyre në procesin e të nxënit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/ Rregulloren e Institucionit/ rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, aftësive, kompetencave profesionale përcaktohen në rregulloret e institucionit, rregulloren e programit si dhe në syllabusin e secilës lëndë. Në këto rregullore janë parashikuar elementet e procesit të vlerësimit si detyra kursi, punë në grup, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare. Mënyra e vlerësimit përcaktohet specifikisht për çdo lëndë në syllabus, në bazë të specifikave të saj. Studentet njihen me këto rregullore si një e drejtë dhe detyrim i tyre, si dhe janë parashikuar si pjesë përbërëse e kontratës së shkollës dhe studentit. Ato janë të publikuara dhe studentët mund t'i aksesojnë në çdo moment. Procesi i vlerësimit përgjithësisht rezulton të jetë: – 10 % projekte, detyra, laboratore – 40 % Kolokiume/provimet e ndërmjetme – 50 % provimi përfundimtar. [Evidenca 19 Rregullorja UAMD], [Evidenca 28 Rregullorja e programit të studimit TE].
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ konstaton se në rregulloren e UAMD-se, rregulloren specifike të programit të studimit, përcaktohet detyrimi për të informuar studentët në fillim të çdo moduli/ lënde me metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Referuar takimeve me stafin dhe studentet, rezulton që procesi i informimit të jetë një praktikë e ndjekur jo vetëm nga stafi akademik në ditët e para të leksioneve që zhvillon me studentët, por edhe në udhëzimet e hartuara në formë manuali të përmbledhur për studentët e të shpallur në faqen zyrtare të UAMD. Në mënyrë specifike, studentët njihen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit nëpërmjet sqarimit nga ana e pedagogut të lëndës të syllabusit përkatës. [Evidenca 19 Rregullorja UAMD], [Evidenca 28 Rregullorja e programit të studimit TE]. [Vizita në UAMD, takimi me studentët]
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori	Referuar rregulloreve institucionale, GVJ konstaton se testimi i njohurive dijeve dhe aftësive të fituara nga studentët realizohet duke vlerësuar me pikë pjesëmarrjen dhe aktivizimin, detyrat e kursit, (projekte etj), laboratorët, provimet e ndërmjetme dhe provimit përfundimtar. Në nivel programi studenti vlerësohet edhe për praktikën dhe detyrimet përmbyllëse për provimin përfundimtar. Teza e provimit hartohet duke kombinuar pyetjet me alternativa,

ashtu edhe në aftësitë praktike.	zbërthim konceptesh, ushtrime praktike si dhe ushtrime të ndryshme sipas lëndës. Mënyra e vlerësimit dhe shpërndarja e pikëve brenda lëndës dhe argumenteve të saj bëhet sipas gjykimit të pedagogut përgjegjës të lëndës dhe më pas miratohet nga drejtuesi i njësisë bazë. [Evidenca 19 Rregullorja UAMD], [Evidenca 28 Rregullorja e programit të studimit TE], [Vizita në UAMD, takimi me studentët]			
Konkluzione	<i>UAMD ka të detajuara në rregulloren e programit të studimit dhe në secilin syllabus, mënyrat dhe kriteret e vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët. Informacioni u bëhet i ditur studentëve paraprakisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi i dijeve të studentëve bëhet duke u bazuar në pikët e grumbulluara gjatë vitit sipas formave të vlerësimit të vazhduar gjatë semestrit, sipas komponentëve të përcaktuar në syllabusin e lëndës, ku pesha në % dhe mënyrat e vlerësimit janë specifike sipas llojit të lëndës dhe në tërësi rezultojnë si një vlerësim i pjesëmarrja në laboratore, detyra, vlerësimi në Kolokiume/provime të ndërmjetme dhe vlerësimi në provimin përfundimtar të lëndës. Informacioni gjendet në syllabusin e lëndës, gjithashtu studentët informohen nga pedagogu përgjegjës. Gjithashtu, ky informacion gjendet edhe në rregulloren e programit të studimit. [Evidenca 126 Syllabuset TE], [Evidenca 28 Rregullore e Programit të studimit TE], [Vizita në UAMD, takimi me studentët]
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Për të siguruar transparencën, objektivitetin e vlerësimit të njohurive të studentëve dhe për të shmangur rastet e subjektivizmit, UAMD ka vënë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. UAMD që nga viti 2018 është pjesë e projektit CleanScore 2016-2018 të Albanian-American Development Foundation (Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim AADF). Projekti CleanScore përbëhet nga dy komponentë të rëndësishëm për arsimin e lartë në Shqipëri: vlerësimin e automatizuar të testeve dhe vënien në dispozicion të teksteve akademike ndërkombëtare. Të dy këto komponentë ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në Cilësinë e Arsimit të Lartë. Stafit akademik ka patur mbështetjen e stafit IT për

	mbarëvajtjen dhe organizimin e sistemeve elektronike të përdorura në funksion të përcimit dhe testimit të dijeve. [Vizita në institucion, takimi me stafin akademik]
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësim përfundimtar realizohet nga komisionet e provimeve (jo më pak se 2 pedagogë, nën drejtimin e titullarit të lëndës) të ngritura nga njësia bazë konform rregullores së programit të studimit.. Komisioni i provimit, gjithashtu, vlerëson në tërësi studentit bazuar edhe në vlerësimet e vazhduara gjatë zhvillimit të lëndës sikurse është parashikuar në syllabusin e lëndës, ku forma përfundimtare e vlerësimit është një peshim i vlerësimeve gjatë vitit dhe provimit përfundimtar. [Evidenca 126 Syllabuset TE], [Evidenca 28 Rregullore e Programit të studimit TE], [Vizita në UAMD, takimi me studentët]
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i njohurive bëhet sipas rregulloreve të UAMD-së. GVJ nga dokumentacioni dhe takimi me studentët konstaton se në kontrollin e dijeve vlerësohen dijet dhe puna individuale e studentit. Nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente /feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimeve të detyrave të kursit/projekteve, duke iu dhënë këshilla/orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen. [Evidenca 126 Syllabuset TE], [Evidenca 28 Rregullore e Programit të studimit TE], [Vizita në UAMD, takimi me studentët]
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Njësia bazë dhe personeli akademik bazohen në rregulloret institucionale dhe kodin e etikës lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes, dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiature gjatë procesit të provimit. Në rast se studenti thyen rregullat e provimit, ai ndërpret provimin dhe plotësohet procesverbali për parregullsi në provime nga personeli akademik i lëndës dhe asistent pedagogu apo Komisioni përkatës. Gjithashtu, procesverbalit i bashkëngjitet provimi i cili vlerësohet me 0 pikë. Procesverbali duhet të jetë sipas formatit në aneksin bashkëngjitur rregullores. Kur studentit i plotësohet procesverbal për parregullsi në provime, ai nuk lejohet t'a japë lëndën në sezonin e riprovimeve, por duhet t'a frekuentojë përsëri atë. Për sa i përket detyrave të kursit, personeli akademik dhe drejtuesi i njësisë bazë, orientojnë/miratojnë tematika kryesisht aplikative ose gjysmë aplikative, ku të dhënat që përdoren të jenë autentike. Çdo anëtar i stafit akademik dhe jo akademik sipas detyrave të ngarkuara është përgjegjës për garantimin e një niveli të lartë të ndershmërisë në çdo kohë dhe rrethanë, referuar draft kontratës së pedagogut dhe kodit të etikës në UAMD. [Evidenca 18 Statuti i UAMD], [Evidenca 27 Rregullorja DSID],

	[Evidenca 28 Rregullorja e programit të studimit].			
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	GVJ, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore konstaton që vlerësimi kryhet me sistem pikëzimi nga 0 (zero) në 100 (një qind). Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve nga sistemi elektronik i sekretarisë mësimore, ose/dhe me komunikim verbal dhe individual, në departament. Në raste kur provimet zhvillohen me shkrim, komisioni shpall dhe çelësin e zgjidhjes. Teza korrigjohet nga komisioni dhe brenda tre ditëve, studenteve ju komunikohen rezultatet paraprake nëpërmjet sistemit elektronik. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit teza depozitohet në departament. Gjatë vitit pedagogët janë të lirë të alternojnë metodat kontrolluese dhe vlerësuese të cilat përfshijnë kontroll të vazhdueshëm nëpërmjet provimeve, teste me pyetje alternative, kuice, prezantime në grup ose individuale, etj. Shkalla e përvetësimit të dijeve ose vlerësimi për secilën lëndë dhe për Praktikën Profesionale kryhet pas përfundimit të saj me sistemin e pikëve (1000 pikë totali), i cili konvertohet në sistemin e notave, nga nota minimale 4 deri në notën maksimale 10. Nota kaluese më e ulët është nota 5 (pesë) e cila korespondon me 51% të pikëve të fituara, dhe nota më e lartë 10 merret me 935-1000 pikë. [Evidenca 28 Rregullorja e programit të studimit TE]			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Referuar takimit me studentet, GVJ konstaton se ata njohin të drejtën e tyre për ankimim. Pas shpalljes së rezultateve paraprake nga pedagogu në sistem, studenti ka të drejtën e kontestimit të mundshëm brenda afateve të përcaktuara në rregullore. Pas kontestimit të notës nga studenti, kërkesa e tij për rivlerësim shqyrtohet nga komisioni i provimeve dhe pedagogu i lëndës të cilët më pas vendosin për notën përfundimtare. Pas kësaj faze, nëse studenti gjykon se ka të drejtë, sërisht mund të kontestojë vlerësimin në instanca më të larta, ku kërkesa shqyrtohet me një komision të veçantë deri në Rektorat. [Evidenca 18 Statuti UAMD], [Evidenca 28 Rregullorja e programit të studimit TE],			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Kërkesa për ankimim shqyrtohet nga komisioni fillestar apo komisionet e tjera të ngritura, duke respektuar rregulloret institucionale dhe rregulloret e tjera që lidhen me procesin e provimeve në UAMD. [Evidenca 18 Statuti i UAMD], [Evidenca 28 Rregullorja e programit të studimit TE],			
Konkluzione	UAMD vlerëson studentet në formë transparente dhe asnjansë duke garantuar të drejtën e tyre për tu informuar rreth vlerësimit dhe procedurat për kontestimin e vlerësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës konstaton se plani mësimor i programit të studimit Profesional në “Teknikë Elektrike”, përfshin lëndë teorike dhe praktike në fushën e zbatimeve elektrike (instalime elektrike në industri/rezidenca banimi ,impiante elektrike të fuqisë dhe burimet e energjisë së rinovueshme), praktiken profesionale dhe provimin përfundimtar. Kjo kurrikul parapërgatit studentët në thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta në fushën sistemeve elektrike dhe shpërndarjes e transmetimit të energjisë elektrike. Programi i studimit “Teknikë Elektrike” garanton zhvillimin e aftësive të veçanta për specialistë të fushës elektrike me aftësi praktike-teknike për prodhimin, shpërndarjen dhe transmetimin e energjisë elektrike, duke lehtësuar punësimin tyre në sistemin e prodhimit, shpërndarjes dhe transmetimin e energjisë elektrike, në kompani për projektimin, realizimin dhe servisin e sistemeve të fuqisë me tension të lartë, të mesëm dhe të ulët, në shoqëri për shitblerjen e energjisë elektrike, në industrinë e prodhimit të aparateve dhe pajisjeve elektrike, në industri të ndryshme prodhuese e në servise të ndryshme që merren me riparime pajisjesh elektrike. Syllabuset e lëndëve paraqesin objektivat, aftësitë dhe kompetencat që fiton studenti në secilën lëndë si dhe format e vlerësimit të njohurive. Njësia bazë, ofron shërbime shtesë krahas procesit mësimor, të tilla si konsultime apo leksione të hapura. Staf i akademik përfshin studentët në veprimtari jashtë kurrikulare. Gjithashtu, shkëmbimet e studentëve ndihmojnë në përthithjen e aftësive praktike në fushën e studimit. Studentët inkurajohen për të punuar në grup gjatë aktiviteteve laboratorike duke praktikuar sipas moduleve të mirëfillta didaktike/laboratorike për përçimin e njohurive në këtë fushë. UAMD ka krijuar një bazë komunikimi dhe marrëdhëniesh, e cila i siguron kushte dhe mundësi për të realizuar praktikat profesionale dhe internshipe për studentët. Në politikat e tij, DSID, e ka në fokus zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me institucione arsimore si dhe me organizatat e biznesit dhe institucionet shtetërore. [EVIDENCA nr. 48 “Dosja e aplikimit në MASR për riorganizimin e programit 2-vjeçar të studimit Diplomë Profesionale “Teknikë Elektrike”, Formulari i aplikimit sipas Shtojcës 1 të Udhëzimit të MASR nr. 31, datë 29.12.2017”] [Vizita në UAMD]
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se plani mësimor i programit të studimit që

veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	zhvillohet në dy vite akademike në gjuhën shqipe, garanton përveç zhvillimit të aftësive në fushën e zbatimeve elektrike, që është pjesë e kompetencës së këtij programi studimi, mbështet edhe zhvillimin e aftësive specifike në fushën sociale dhe të komunikimit, përfshirë dhe njohjen e legjislacionit në shpërndarjen e energjisë elektrike. [Evidenca 128 Kurrikula dega TE vitet 2020-2024].
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në zbatim të përcaktimeve në rregulloren e IAL, në fund të çdo semestri analizohen dhe rishikohen kompetencat dhe aftësitë e studentëve, të paraqitura në syllabuset e lëndëve të programit të studimit. Detyrat e ndryshme të kursit, projektet, literaturat ndihmëse janë mjete që zhvillojnë aspekte të komunikimit dhe ndërveprimit në grup. Këto detyra janë një mënyrë edhe për të analizuar kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studentët. Analiza që në tërësi, shqyrtohen nga njësia bazë dhe më pas bëhen pjesë e diskutimeve në senatin akademik, përpara fillimit të vitit të ri akademik. [EVIDENCA nr. 133 “Raportet e analizës vjetore të DSID për vitet 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021 Anekset e statistikave për çdo lëndë dhe çdo program studimi”]
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/ çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se procesi mësimor realizohet me objektivin kryesor që t’u japë studentëve mundësinë për të zhvilluar kompetencat e tyre në laboratorët në auditor dhe praktikë mësimore jashtë auditorit . Institucioni ka garantuar dy laboratorë të cilët janë të mirëfilltë didaktikë, “Laboratori Elektrik” i ndërtuar me kontributin e stafit akademik dhe laboratorit i sistemeve të energjisë së rinovueshme, i ngritur me bazë financimi nga pjesmarrja në një projekt në UAMD, i cili paraqet edhe argumentet teorike dhe praktike të nevojshëm për përvetësimin e kompetencave praktike. GVJ vizitoi laboratorët dhe konstatoi se studentët e programit të studimit Profesional në “ Teknikë Elektrikë” kanë në tërësi laboratorët dhe pajisjet e nevojshme për të zhvilluar laboratorët dhe vënë në praktikë projektet edhe dijet e tyre. Studentët zhvillojnë edhe praktika profesionale si një lëndë e programit të studimit, e cila kryhet në pozicione pune sa më pranë fushës së studimit të programit, me synim rritjen e aftësive profesionale dhe integrimin më të mirë në tregun e punës. [EVIDENCA nr. 129 “Tabela për Institucionet dhe organizatat me të cilat Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë, Fakulteti i Studimeve Profesionale, Universiteti “Aleksandër Moisiu”. Durrës kanë bashkëpunime”]
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se gjatë zhvillimit të programit të lëndës, personeli akademik krahas zhvillimit të mësimit të parashikuar në auditor, organizon dhe zhvillon leksione/seminare të hapura me pjesëmarrjen e

teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	studentëve. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit dhe workshopeve të ndryshëm, ku studentët kanë mundësinë e zgjerimit të dijeve dhe prezantimit me risi në fushën ku ata studiojnë. Personeli akademik organizon dhe zhvillon mësimet të hapura për studentët me industrinë dhe biznesin mbi zhvillimet e reja të teknologjisë në fushën e studimit, ku ftohen dhe marrin pjesë ekspertë të fushës dhe të ftuar të tjerë për të ndarë eksperiencën e tyre me studentët. [EVIDENCA nr. 84 "Informacion për leksionet e hapura , workshop dhe seminare me studentët"]			
Konkluzione	Programi i studimit është i organizuar me një ndarje të aktiviteteve teorike dhe atyre praktike në një masë rreth 1:1 (50% me 50%) duke mundësuar rritjen e aftësive profesionale. Institucioni mundëson, përtej aktiviteteve të parashikuara laboratorike, edhe përdorimin e bazës laboratorike nga studentët për realizim të projekteve apo ideve të tyre inovatore me mbështetjen e stafit akademik dhe administrativ.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se UAMD ka hartuar rregullore ku në mënyrë të posaçme jepet informacion për procedurën në provimin final apo atë të mbrojtjes së diplomës. Diplomimi për programin me karakter profesional TE bëhet nëpërmjet një provimi të përgjithshëm përfundimtar. Procedura specifike për provimin final u vihet në dispozicion para diplomimit të studentëve së bashku me një fond pyetjesh për orientim. [EVIDENCA nr. 28 "Rregullore e c programit të studimit "Teknikë Elektrike", miratuar me Vendimin të Departamentit nr. 6, me nr. 337 Prot., datë 28.05.2019, Kreu III Organizimi i studimeve në programin 2-vjeçar "Teknikë Elektrike", Seksioni I - Struktura dhe organizimi i programit të studimit, neni 43 Mbrojtja e diplomës, Seksioni II Vlerësimi i studentëve, neni 47 Vlerësimi i provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomës"]
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë	UAMD dhe në veçanti personeli akademik, asistojnë studentët me informacionin, udhëzimet dhe materialet e nevojshme në kuadër të provimit përfundimtar dhe mbrojtjes së diplomës. Gjithashtu njësia

në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	bazë përgjegjëse për programin e studimit TE, DSID, pajis studentët me dokumentacionin udhëzues në lidhje me përmbylljen e këtij detyrimi konform përcaktimeve në rregullore. Takimet me koordinatorin e programit në veçanti, i ndihmojnë studentët të kuptojnë edhe më mirë mënyrën e zhvillimit të provimit si dhe mbrojtjes së diplomës. Në funksion të asistimit të studentëve dhe transparencës koordinatori i programit të studimit në përfundim të semestrit të parë u shpërndan studentëve fondin e pyetjeve për provimin e formimit që ndërtohen në përputhje me kurrikulat mësimore të programit të studimit. [EVIDENCA nr. 28 “Rregullore e e programit të studimit “Teknikë Elektrike”, miratuar me Vendimin të Departamentit nr. 6, me nr. 337 Prot., datë 28.05.2019, Kreu III Organizimi i studimeve në programin 2-vjeçar “Teknikë Elektrike”, Seksioni I - Struktura dhe organizimi i programit të studimit, neni 43 Mbrojtja e diplomës, Seksioni II Vlerësimi i studentëve, neni 47 Vlerësimi i provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomës”]
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në rregulloren e UAMD, është e përcaktuar se Teza e Provimit të përgjithshëm përfundimtar është e përbërë nga grupe të ndryshme pyetjesh të përgatitura për të testuar njohuritë e lëndëve teknike që studentët kanë ndjekur gjatë këtij programi studimi. Përqindja e secilit prej grup pyetjeve përcaktohet në bazë të ngarkesës së lëndës (krediteve) në kurrikul dhe raportit të tyre me lëndët e tjera. Komisioni i provimit përgatit tezën për provimin e përgjithshëm përfundimtar bazuar në pyetjet e paraqitura nga secili pedagog i përfshirë në proces, sipas përqindjes së përcaktuar. [EVIDENCA nr. 28 “Rregullore e e programit të studimit “Teknikë Elektrike”, miratuar me Vendimin të Departamentit nr. 6, me nr. 337 Prot., datë 28.05.2019, Kreu III Organizimi i studimeve në programin 2-vjeçar “Teknikë Elektrike”, Seksioni I - Struktura dhe organizimi i programit të studimit, neni 43 Mbrojtja e diplomës, Seksioni II Vlerësimi i studentëve, neni 47 Vlerësimi i provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomës”]
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para	Stafi akademik përfshihet në konsultimin për provimin e përgjithshëm përfundimtar sipas një orari të caktuar dhe të bërë publik për studentët. Kryetari i komisionit të provimit të përgjithshëm përfundimtar organizon dhe ndjek orarin e konsultimit të realizuar nga pedagogët e secilit argument. [EVIDENCA nr. 28 “Rregullore e e programit të studimit “Teknikë Elektrike”, miratuar me Vendimin të Departamentit nr. 6, me nr. 337 Prot., datë 28.05.2019, Kreu III Organizimi i studimeve në programin 2-vjeçar “Teknikë Elektrike”, Seksioni I - Struktura dhe organizimi i programit të studimit, neni 43 Mbrojtja e diplomës, Seksioni II Vlerësimi i studentëve, neni 47 Vlerësimi i provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomës”]




komisionit.	
Kriteri 5. Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.	Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve infrastrukturën, si dhe staf ndihmës për ti asistuar në kryerjen e matjeve, analizave dhe testeve të ndryshme. Personeli akademik dhe ndihmës akademik ndihmojnë studentët në zhvillimin e pjesëve praktike të punimeve të tyre të diplomës.
Kriteri 6. Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.	Provimi përfundimtar ose projekti i diplomës vlerësohet me notë, nga komisioni i provimit ose i mbrojtjes së diplomës. Vlerësimi përfundimtar është një mesatare e vlerësimeve të pavarura të anëtarëve të komisionit pas prezantimit të temës nga kandidati dhe pas përgjigjeve të pyetjeve të ngritura nga komisioni. Nota i komunikohet studentit në prani të komisionit nga kryetari i tij. Në rastin e provimit përfundimtar, nota del pas vlerësimit të çdo tematike nga anëtari i komisionit përgjegjës për grup-pyetje brenda fushës së tij të ekspertizës. [Evidenca 27 Rregullorja DSID], [Evidenca 28 Rregullorja e programit të studimit TE]
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me “Çertifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, pasi studenti plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë 120 kredite ECTS, zyrat administrative përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin. Sekretaria mësimore pajis studentët e diplomuar me diplomën dhe suplementin e diplomës sipas formateve të aprovuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Diploma plotësohet me shkrim të qartë e me bojë teknike, nënshkruhet nga Drejtuesi i njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, nënshkruhet nga rektori dhe vuloset me vulën e UAMD. Diploma lëshohet vetëm një herë, dhe regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor që administrohet nga QSHA (Qendra e Shërbimeve të Arsimit). [Evidenca 18 Statuti i UAMD], [Evidenca 27 Rregullorja DSID], [Evidenca 28 Rregullorja e programit të studimit TE], [Evidenca 49 Suplementi i diplomës TE.] EVIDENCA nr. 10 “Regjistrimi i Diplomës Profesionale në “Teknikë Elektrikë” me Urdhër Drejtori i QSHA nr. 122, datë 05.06.2019 dhe vërtetim për numrin e identifikimit i QSHA, nr. 2506/89, datë 05.06.2019”
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	UAMD, përveç sistemit elektronik në përdorim nga sekretaria mësimore, në funksion të qëllimit të saj administrativ, ruan dhe plotëson dokumentacionin themeltar të kërkuar nga kuadri ligjor në fuqi. Në veçanti, institucioni plotëson dhe ruan tre regjistra kryesor me të dhëna të plota të studentëve, arrijtjet e tyre akademike deri në diplomim.

	Regjistrat e më sipërm, janë sipas formatit të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, dhe plotësimi i tyre realizohet në përputhje të udhëzimeve përkatëse të detajuara nga po kjo ministri. Institucioni ka detyrimin ligjor, që në përfundim të kohës së parashikuar të mbajtjes së këtyre regjistrave pranë institucionit, ti depozitojë ato pranë arkivave të shtetit, duke mbajtur pranë institucionit, një kopje të njehsuar me origjinalin. Nga ku mund të nxirret çdo informacion i nevojshëm për studentët që kanë frekuentuar këtë institucion. [Vizita në institucion, takimi me sekretarinë mësimore]			
Konkluzione	<i>Institucioni ka përcaktuar qartë rregulloret për diplomimin e studentëve (me provim përfundimtar), përfshirë këtu edhe mënyrën e vlerësimit.</i> <i>Institucioni mban dhe pajis studentët me të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, duke përfshirë diplomën sipas formatit të miratuar dhe me numër unik, regjistrat themeltar, atë të avancimit akademik dhe atë të diplomimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se UAMD ka hartuar rregullore dhe udhëzues në nivel institucional për përmirësimin e metodave të mësimdhënies nëpërmjet përdorimit të teknologjisë inovative referuar natyrës dhe fushës specifike të studimeve, lëndëve dhe moduleve të programeve të studimit. Në strukturën e UAMD ekziston Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJBSC) dhe Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Standardeve të Cilësisë (DKSC-ja) që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me NJSBC të fakulteteve dhe njësitë bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, hartojnë udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. UAMD përdor metodologji dhe infrastrukturë bashkëkohore të mësimdhënies, sidomos atë laboratorike, për të rritur efikasitetin në mësimdhënie dhe mësimnxënie. UAMD/FSP/DSID ka organizuar trajnime dhe udhëzime mbi përdorimin e metodave dhe teknikave të




	ndryshme sipas nevojave të njësive bazë të si nga zyra e IT për përdorimin e infrastrukturës IT si online gjatë periudhës së diktuar nga përhapja e virusit Sars-Cov2, ashtu edhe në auditor. Gjithashtu, institucioni parashikon edhe në syllabuset e lëndëve aktivitete laboratorike të bazuar në zhvillimet më të fundit teknologjike në fushën e zbatimeve elektrike industriale, rezidenciale dhe sistemeve efëiente të energjisë. [EVIDENCA nr. 67 "Udhëzues në nivel institucional për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies"], [Vizita në institucion, takimi me stafin akademik të PS dhe studentët]
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	UAMD ka të përcaktuar qartë se struktura përgjegjëse për monitorimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe ndihmës akademik është njësia bazë, Departamenti. Në nivelin e njësisë bazë, mësimdhënësia dhe aftësitë inovative të personelit akademik vlerësohen rregullisht nga drejtuesi i njësisë bazë si dhe nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Në bazë të RVB, dokumenteve të vënë në dispozicion, si dhe shpjegimeve të marra gjatë vizitës në IAL, konstatohet se institucioni zhvillon mekanizma monitorimi dhe vlerësimi të cilësisë së mësimdhënies së stafit akademik si: - vlerësimi nga studentët në fund të semestrit me anë të pyetësorëve; - vetëvlerësimi; 1) DKSC-ja është e përbërë nga dy sektorë me këto detyra kryesore: Sektori i Degës Mësimore ndjek me përparësi mbarëvajtjen dhe shqetësimet që lidhen me mësimin dhe në bashkëpunim me departamentet realizon rishikimin periodik të programeve ekzistuese që ofrohen në UAMD me objektiv përmirësimin cilësor të tyre. 2) Sektori i Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë bashkëpunon me Dekanët dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së Fakultetit të Studimeve Profesionale. për realizimin e vetëvlerësimit dhe ecurinë e veprimtarisë mësimore. EVIDENCA nr. 43 "Vendim Dekanati i FSP nr. 10, nr. 186 Prot., datë 22.04.2021 për NJSBC së FSP" EVIDENCA nr. 75 "Formularët e Vetëvlerësimit të personelit akademik të DSID viti 2019-2020".
Kriteri 3. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Statuti i UAMD dhe rregulloret e tij, kanë të përcaktuar departamentin si përgjegjës për sigurimin e cilësisë së programeve që mbulon. Në të njëjtën kohë UAMD ka të ngritur edhe NJSBC që ka detyrë specifike monitorimin e cilësisë në mësimdhënie, si dhe rekomandon dhe ndjek marrjen e masave për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë. Rezultatet e vlerësimit përpunohen nga NJSBC, dhe nga zyra e IT në rastin e vlerësimeve online, i komunikohen autoriteteve drejtuese të UAMD, si edhe anëtarëve të personelit akademik nga drejtuesi i njësisë bazë

	ku analizohen rezultatet dhe merren masa për përmirësimet e nevojshme. Stafi akademik vihet në dijeni rast pas rasti dhe problematikat adresohen në departament. Rezultatet e pyetësorëve të përmbledhura jepen në raportet vjetore të hartuara nga NJSBC. Këto raporte nuk janë të publikuara në faqen zyrtare web të institucionit. <i>GVJ rekomandon që IAL duhet të bëjë publike në faqen web zyrtare, rezultatet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, duke ruajtur konfidencialitetin e të dhënave.</i> [Evidenca 136. Raporti vjetor 2020-2022 FSP], [Evidenca 131 Raporti vjetor 2019-2021 DSID]
--	--

Kriteri 4. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.

UAMD dhe njësitë bazë përbërëse të tij, përdorin rezultatet e vlerësimeve periodike të hartuara nga NJSBC si dhe nga vlerësimet e drejtë për drejta në ndjekjen e stafit akademik, për të njohur situatën e zhvillimi të të gjithë aktivitetit didaktik, dhe administrativ në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe të përmirësimit të tij.

Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, ka një staf akademik të qëndrueshëm në vite, ç'ka ka sjellë edhe një njohje më të mirë jo vetëm të aktiviteteve didaktike nga stafi, por në tërësi të objektivave formuese që studentët duhet të përvetësojnë me përfundimin e këtij cikli studimi. Stafi është trajnuar vazhdimisht me institucionet partnere në kuadër të rritjes së aftësive në mësimdhënie dhe zhvillimin e praktikave laboratorike, si me zhvillimin e leksioneve të hapura, seminareve workshope, ashtu edhe me vizita trajnuese në institucionet partnere jashtë vendit. Institucioni është i përfshirë në projekte ndërkombëtare, si dhe ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me institucione ndërkombëtare për mobilitete të stafit dhe studentëve.

[Evidenca 63 Mobilitetet staf dhe student në UAMD], [Evidenca 65 Informacion në kuadër të projekteve në UAMD]

Konkluzione

UAMD ka procedura dhe njësi të dedikuara për monitorimin e brendshëm të cilësisë. Gjithashtu ka mbështetur trajnimet e vazhdueshme të stafit dhe pjesëmarrjen e tyre në projekte në kuadër të përmirësimit të aftësive mësimdhënëse dhe atyre praktike.

Shkalla e përmbushjes së standardit

Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III

Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Personeli akademik dhe ndihmës akademik, i angazhuar në realizimin e programit të studimit me karakter profesional në “Teknikë Elektrikë”, i përmbush kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e kualifikimit akademik, pasi i gjithë stafi akademik efektiv ka së paku diploma Master i Shkencave , nga Master Profesional që parashikon ligji. Drejtuesi i programit të studimit, drejtuesi i DSID ka titullin akademik Doktor. Viti akademik 2023-2024 stafi i programit: 5 PAE (4 Msc, 1 Dr)/ 1 PAK (Dr); Viti akademik 2022-2023 stafi i programit: 5 PAE (4 Msc, 1 Dr)/ 1 PAK (Dr); Viti akademik 2021-2022 stafi i programit: 4 PAE (4 Msc)/ 2 PAK (1 Dr, 1 Msc); Personeli akademik i angazhuar në mbulimin e lëndëve/ moduleve të programit, ka ekspertizën e nevojshme për fushën kërkimore dhe eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. DSID tregon kujdes që në fazën e rekrutimit të PAE ose PAK duke vlerësuar eksperiencën në punë, institucionin ku është shkolluar kandidati, motivimin që ai paraqet në lidhje me mësimdhënien, rezultatet individuale profesionale etj. [EVIDENCA nr. 23 “Dosje personale e personelit akademik të DSID, me kohë të plotë dhe jo të plotë që zhvillon mësim në programin e studimit “Teknikë Elektrike” EVIDENCA nr. 25 “C-V e personelit akademik të DSID, me kohë të plotë dhe jo të plotë që zhvillon mësim në programin e studimit “Teknikë Elektrike” EVIDENCA nr. 131 “Artikujt e botuar në revistat shkencore ndërkombëtare, me ISSN dhe me ose pa faktor impakti”]
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Personeli akademik efektiv angazhuar për programin e studimit profesional në “Teknikë Elektrikë” mbulon ngarkesën mësimore kryesisht në përputhje me kornizën ligjore në fuqi të sanksionuar me aktet e brendshme rregullatore të UAMD, 88% e ngarkesës mwsimore pwr vitet akademik 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024 mbulohet nga PAE dhe vetem 12% nga PAK, (Vendim Senati Akademik) dhe të

	shprehur në kontratën individuale të punës që PAE/ PAK ka me institucionin. Nga të dhënat që paraqiten për ngarkesën mësimore të PAE, vihet re mbingarkesë mësimore për 2 PAE (me mbi 490 orë dhe rreth 900 orë mësimore), por ka raste edhe nën ngarkimi. Në fund të çdo viti akademik bëhet parashikimi i ngarkesës mësimore për vitin e ardhshëm akademik për personelin efektiv, pas dakortësimit në mbledhjen e departamentit. DSID nuk ka Personel ndihmësakademik në shërbim të këtij programi studimi, i rëndësishëm në ndjekjen e Praktikave profesionale. [EVIDENCA nr. 76 “Udhëzim i MASR nr. 29, datë 10.09.2018 Për veprimtarinë dhe ngarkesës mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë; i ndryshuar me Udhëzimin nr. 36, datë 23.11.2018 dhe Udhëzimin nr. 37, datë 04.12.2018” EVIDENCA nr. 122 “Marrëveshje e lidhur mes Përgjegjësit të DSID dhe personelit akademik për organizimin e kohës vjetore të punës – parashikimi për vitin 2021-2022” EVIDENCA nr. 134 “Tabela e ngarkesës mësimore për personelin akademik me kohë të plotë për programin e studimit “Teknikë Elektrike”]
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	DSID në UAMD dëshmon një qëndrueshmëri në përbërjen e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit me karakter profesional në “Teknikë Elektrikë”, pasi vihet re se stafi akademik efektiv ka ndryshime të vogla dhe ato janë kryesisht në zvogëlimin e numrit. Kjo lidhet me një faktor objektiv, siç është zvogëlimi (rreth 20-25%) i numrit të studentëve në këtë program studimi. Kjo qëndrueshmëri, edhe pse në kushte jo të mira në aspektin e prurjeve të reja, është për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore në mbështetje të plotë me ligjet në fuqi. Sipas përcaktimeve në Statut e UAMD, personeli akademik ka të përcaktuar veç të tjerash në kontratën individuale me institucionin edhe formën e angazhimit dhe kohëzgjatjen e kontratës. [EVIDENCA nr. 77 “Kontratat e punës për personelin akademik me kohë të plotë dhe jo të plotë të angazhuar në mësimdhënie për programin e studimit “Teknikë Elektrike”], [Evidenca 18. Statuti I KPT]
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe	Nga verifikimi i procedurave të punësimit për personelin akademik dhe ndihmës akademik të programit të studimit me karakter profesional në “Teknikë Elektrikë” në UAMD, del e qartë se Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike zbaton procedura që parashikohen në Rregulloren dhe Statutin e UAMD, dhe në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Procedura fillon me marrjen e kërkesës prej departamentit që ka vend vakant (kërkesa i drejtohet Rektorit të UAMD), shoqëruar me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përzgjedhjes dhe pranimit së kandidatit dhe grupin e lëndëve që ka

përmbajtjen e programit të studimit.	interes DSID. Vendi vakant shpallet në faqen web të UAMD sëbashku me kriteret e përzgjedhjes së kandidatit. Kandidatët vlerësohen dhe përzgjidhen sipas meritave nga komisioni Ad-Hoc i ngritur pranë departamentit.. Nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike bëhet njoftimi përfundimtar për rezultatin e konkursit tek kandidatët pjesëmarrës. Aktet e brendshme rregullatore të UAMD kanë të shprehura procedurat dhe kriteret e përgjithshme për rekrutimin e personelit akademik. Kriteret specifike të rekrutimit shprehen prej njësisë bazë në përputhje me nevojat që ka. Këto kritere specifike i bëhen me dije Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike dhe kjo e fundit i bën publike në njoftimin e bërë në faqen web të UAMD. [EVIDENCA nr. 78 "Paketa e BNJ për rekrutimin e personelit akademik dhe praktika e ndjekur departament- dekanat-burime njerëzore-rektorat"]
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	UAMD dhe DSID duke ndjekur një procedure përzgjedhjeje dhe punësimi transparente dhe të detajuar në aspektin e kriterëve për kandidatët, siguron zbatimin e parimeve të paanshmërisë dhe meritokracisë në rekrutimin e PAE/PAK me qëllim garantimin e angazhimit të personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për: 1) realizimin e orëve mësimore/ laboratorike /praktikë mësimore 2) për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. Nga vëzhgimi i laboratoreve vihet re se personeli akademik dhe ndihmës akademik angazhuar me laboratorët, kryen punë të mirë në pasurimin e laboratoreve me objekte (pajisje elektroshtëpiake të dëmtuara, për riparim) në ndihmë të temave praktike të zhvilluara si dhe përfshirjen e studentëve në këtë pasurim, me qëllim rritjen e interest dhe të rëndësisë praktike të lëndëve që zhvillojnë. [Vizita në institucion]
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik dhe	UAMD ka pjesë të strukturës Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Juridike e cila mban përgjegjësi për përmblidhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave për personelin akademik dhe ndihmës akademik të përfshirë në programin e studimit dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ të angazhuar. Kjo strukturë vepron në nivel institucioni. Nga takimi me anëtarët e kësaj zyre dhe verifikimi me zgjedhje i dokumentacionit që kjo drejtori ka në administrim, u vu re se dokumentacioni për stafin akademik të rekrutuar bëhet konform ligjit dhe konform akteve rregullatore të brendshme të UAMD. Në dosjen individuale të personelit akademik, përveç dokumentacionit të dorëzuar në pranimin e tij në institucion, janë edhe kontratat e punës me afat të pacaktuar. Procedurat e

administrativ.	ndjekura nga strukturat e UAMD për rekrutimin e personelit akademik vlerësojnë kandidatët e interesuar mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike, të cilat publikohen dhe synojnë të përzgjedhin personel akademik me kualifikimin e duhur, sidomos përvojën praktike të tij dhe në përputhje me natyrën e përmbajtjen e programit të studimit dhe lëndëve që do të zhvillojë. [EVIDENCA nr. 77 “Kontratat e punës për personelin akademik me kohë të plotë dhe jo të plotë të angazhuar në mësimdhënie për programin e studimit “Teknikë Elektrike”], [EVIDENCA nr. 23 “Dosje personale e personelit akademik të DSID, me kohë të plotë dhe jo të plotë që zhvillon mësim në programin e studimit “Teknikë Elektrike”]
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	UAMD në mbështetje të programit të stumit me karakter profesional në “Teknikë Elektrikë” ka marrëveshje dhe bashkëpunon me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani me qëllim kryerjen e praktikave profesionale jo vetëm në ambientet laboratorike që DSID ka ndërtuar (5 marrëveshje janë të dedikuara vetëm për këtë program studimi). Në praktikat profesionale që studentët kryejnë gjatë semestrit të dytë në vitin e dytë akademik, prej 6 javësh, DSID angazhon personel akademik PAE ose PAK në rolin e mbikëqyrës të praktikës, të mjaftueshëm dhe të duhur, në përputhje me kualifikimet e tyre, për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. Sipas rregullores së praktikës profesionale, studentit i caktohet dhe një mbikëqyrës nga institucioni/biznesi pritës, që shërben si pike kontakti për ecurinë e praktikës. Në fund të praktikës, nga DSID organizohet procedura e përmbylljes së praktikës, ku studenti harton një relacion teknik dhe prezantim, sipas një guide të bërë me dije më parë në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e praktikës profesionale. [EVIDENCA nr. 3 “Rregullore e Praktikës Profesionale, miratuar me Vendimin të Dekanatit nr. 3, me nr. 37/2 Prot., datë 31.01.2022, neni 7 Zhvillimi i praktikës, neni 9 Kritere të vlerësimit”], [EVIDENCA nr. 28 “Rregullore e e programit të studimit “Teknikë Elektrike”, miratuar me Vendimin të Departamentit nr. 6, me nr. 337 Prot., datë 28.05.2019, Kreu III Organizimi i studimeve në programin 2-vjeçar “Teknikë Elektrike”, Seksioni I - Struktura dhe organizimi i programit të studimit, neni 42 Zhvillimi i praktikës profesionale, Seksioni II Vlerësimi i studentëve, neni 46 Vlerësimi i praktikës profesionale”]
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë	Në rregulloren e praktikave profesionale, DSID përcakton se është e detyrueshme që të caktohet personel mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve. Ky mbikëqyrës ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve teknike dhe administrative gjatë zhvillimit të praktikës,





studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	udhëzon në hartimin e raportit përfundimtar të praktikës si dhe merr pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale në DSID/UAMD. [Tabela 5. Lista e partnerëve/marrveshjeve të bashkëpunimit për praktikat profesionale në nivel ILA], [EVIDENCA nr. 3 “Rregullore e Praktikës Profesionale, miratuar me Vendimin të Dekanatit nr. 3, me nr. 37/2 Prot., datë 31.01.2022, neni 7 Zhvillimi i praktikës]			
Konkluzione	<i>DSID në UAMD ka personel akademik dhe ndihmës akademik, të angazhuar në realizimin e programit të studimit me karakter profesional në “Teknikë Elektrikë”, që përmbush kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e kualifikimit akademik, pasi i gjithë stafi akademik efektiv ka së paku diploma Master i Shkencave, nga Master Profesional që parashikon ligji, me ekspertizën e nevojshme për fushën kërkimore dhe eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</i> <i>Nga të dhënat që paraqiten për ngarkesën mësimore të PAE, vihet re mbingarkesë mësimore për 2 PAE (me mbi 490 orë dhe rreth 900 orë mësimore) , por ka raste edhe nën ngarkimi. Në fund të çdo viti akademik bëhet parashikimi i ngarkesës mësimore për vitin e ardhshëm akademik për personelin efektiv, pas dakortësimit në mbledhjen e departamentit. DSID nuk ka Personel ndihmës akademik në shërbim të këtij programi studimi, i rëndësishëm në ndjekjen e Praktikave profesionale.</i> <i>UAMD dhe DSID duke ndjekur një procedure përzgjedhjeje dhe punësimi transparente dhe të detajuar në aspektin e kriterëve për kandidatët, siguron zbatimin e parimeve të paanshmërisë dhe meritokracisë në rekrutimin e PAE/PAK me qëllim garantimin e angazhimit të personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</i> <i>DSID angazhon personel akademik PAE ose PAK në rolin e mbikqyrës të praktikës, të mjaftueshëm dhe në përputhje me kualifikimet e tyre, për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale. Sipas rregullores së praktikës profesionale, studentit i caktohet dhe një mbikqyrës nga institucioni/biznesi pritës, që shërben si pike kontakti për ecurinë e praktikës. Në fund të praktikës, studenti harton një relacion teknik dhe prezantim, sipas një guide të bërë me dije më parë në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e praktikës profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
		X		

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	UAMD ka vënë në dispozicion të programeve të studimit që zhvillon mjediset të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, si nga ana logjistike ashtu dhe në drejtim të sigurisë. Ambientet e klasave/zyrave/ambientet e përbashkëta: korridore, tualete etj, janë me hapësira të mjaftueshme në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore. Ambientet janë me dritë, të ajrosura, të mirëmbajtura, të larta, pajisur me mjetet e sigurisë kundër zjarrit vendosur në vende të dukshme, me skemat e evakuimit etj. UAMD ka ambiente që përdoren si laboratore/oficinë e pajisur në përputhje me natyrën specifike të programeve të studimit dhe moduleve përkatëse. Klasat janë të pajisura me projektorë e kompjutera të përshtatshëm për egzekutimin e softeve inxhinierike. [EVIDENCA nr. 79 "Planimetritë e godinës qendrore Currila dhe godinës nr. 1 dhe 2 në Kampusin universitar Spitalë, auditorët dhe laboratorët dhe laboratorët" EVIDENCA nr. 80 "Vendim nr. 418, datë 10.5.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre", Aneksi I pika C.), [Vizita në institucion]
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset mësimore si klasa e laboratorë, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies: 1) klasat janë të përcaktuara sipas madhësisë për leksione/seminare/laboratore. Ato kanë videoprojektorë e kompjutera, për zhvillimin e mësimin në mënyrë të kombinuar. Ka infrastrukture IT të ngritur e të mirëmbajtur, që siguron internet e Wi-Fi në të gjithë ambientet . Numri i ulëseve është deri në 25 për klasat e seminareve. UAMD ka në përdorim edhe një sallë konferencash të mirëpajisur për zhvillimin e takimeve shkencore e prezantimeve në nivel institucioni. 2) laboratorët kanë kapacitete të mjaftueshme për ndërtimin e posteve të punës për 10-12 studentë. Janë të pajisura mirë me mjete didaktike por edhe me risitë teknologjike në lidhje me automatizimin e ndërtesave, industrisë dhe sistemeve të energjisë së rinovueshme. 3) UAMD ka laboratorë me kompjutera të pajisur me softëra të

	duhur për zhvillimin e orëve mësimore në përputhje me kërkesat e programit të studimit me karakter profesional në “Teknikë Elektrikë” [EVIDENCA nr. 81 “Pamje nga laborator i “Teknikë Elektrike” EVIDENCA nr. 82 “Tabela me korrespondencën e shfrytëzimit të laboratorit për program studimi”], [Vizita në institucion]
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	UAMD dhe DSID ka vendosur në dispozicion të programit të studimit me karakter profesional në “ Teknikë Elektrikë” laboratorë dhe baza praktike profesionale të pajisura në përshtatje me natyrën specifike të programit. Këto ambiente përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme didaktike të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. Konkretisht, në laboratore ka module bashkëkohore për zhvillimin e aftësive profesionale në fushën e elektronikës analoge/digitale, ndërtimi dhe funksionimi i sistemeve të automatizuara në ndërtesa e industri (komandimi me mikrokontrollera dhe operimi me PLC për sistemet efçente të energjisë së rinovueshme etj). [EVIDENCA nr. 81 “Pamje nga laborator i “Teknikë Elektrike” EVIDENCA nr. 82 “Tabela me korrespondencën e shfrytëzimit të laboratorit për program studimi”], [Vizita në institucion]
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Duke përfshirë Teknologjitë Virtuale në kulturën akademike, synojnë të përmirësojnë cilësinë në mësimdhënie dhe të kontribuojmë në ndërtimin e mëtejshëm të shoqërisë digjitale në Shqipëri dhe Ballkanin Perëndimor. Për këtë, FSP ka lidhur marrëveshje me FTI për përdorimin e laboratorit të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programeve të studimit që ofron. Gjithashtu, Laboratori HUB i IT është realizuar përmes projektit “Erasmus + CBHE” “Përsheptimi i Modernizimit të Universitetit në Ballkanin Perëndimor përmes Teknologjisë Virtuale” (Accelerating Eastern Balkans University Modernization by Incorporating Virtual Technologies – VTech) ku UAMD është lider në krye të një Konsorciumi prej 11 partnerësh, që ka për qëllim të integrojë për herë të parë në universitetet e Ballkanit Perëndimor konceptin e teknologjive virtuale si një mjet për të përshpejtuar modernizimin e universiteteve. [EVIDENCA nr. 83 “Marrëveshje e lidhur mes FSP dhe Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit” EVIDENCA nr. 84 “Rregullore për funksionimin e HUB e dedikuar për teknologjitë virtuale në UAMD”], [Vizita në institucion]
Konkluzione	<i>UAMD ka vënë në dispozicion të programeve të studimit që zhvillon mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, si nga ana logjistike ashtu dhe në drejtim të sigurisë. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, ofcina, janë të</i>

	pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit (module bashkëkohore dhe sisteme elektronike të përditësuara me përdorim rezidencial e industrial), që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Personeli akademik i DSID që zhvillon lëndët në programin e studimit profesional në “Teknikë Elektrikë” ka vendosur në dispozicion të studentëve literaturë bazë dhe ndihmëse, që përcaktohet edhe në syllabuset përkatëse. Përveç teksteve mësimore në shqip, secili pedagog ka përgatitur leksione të shkruara (që i janë nënshtruar një recenze paraprake nga DSID) që iu jepen studentëve në formë elektronike ose kopje fizike, me qëllim garantimin e marrjes së dijeve dhe njohurive të nevojshme dhe të përditësuara, të parashikuara në programin e studimit. Shumica e lëndëve mbulohet nga literatura e përgatitur nga stafi, si cikle leksionesh të shkruara, në përputhje me syllabuset përkatëse, të vëna në dispozicion studentëve në librarinë e fakultetit, si edhe dhe në variantin elektronik në website http://www.kataloguonline.uamd.al. Kopjet fizike të leksioneve të lëndëve të këtij programi studimi, gjenden të depozituara në Departament dhe në Bibliotekën e UAMD, të aksesueshëm për të gjithë studentët dhe stafi PAE e PAK ku aksesohen pa kufizime materialet mësimore dhe shkencore në funksion të programit të studimit. [EVIDENCA nr. 56 “Tabela e teksteve mësimore dhe literaturave të rekomanduara për çdo program studimi që ofron DSID”] http://www.kataloguonline.uamd.al [EVIDENCA nr. 57 “Lista e teksteve dhe ciklevë të leksioneve të DSID që gjenden në Bibliotekën e UAMD”] [Vizita në institucion]
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e	UAMD ka vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, e cila ka krijuar kushte të përshtatshme për studim dhe jep mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit profesional në “Teknikë Elektrikë”. Falë rregullores së funksionimit të bibliotekës dhe pajisjes së studentëve me kartën e bibliotekës, studentët aksesojnë literaturën e nevojshme sipas orareve

programit të studimit.	të shpallura, sipas përcaktimeve të Statutit të UAMD. [Evidenca 18 Statuti I UAMD], [EVIDENCA nr. 85 “Rregullore e Bibliotekës së UAMD”], [Vizita në institucion]
Kriteri 3. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e UAMD është e pajisur me fond fizik tekstesh mësimore bazë, literaturë ndihmëse dhe leksione të shkruara nga stafi akademik. Tekstet mësimore janë në numër të mjaftueshëm, në gjuhën shqipe dhe të huaja. Nga karakteri që ka ky program studimi, është domosdoshmri përditësimi i vazhdueshëm i literaturës, prandaj përveç librave fondi i bibliotekës pasurohet edhe me revista shkencore të nevojshme ku UAMD është pajtuar, me qëllim mbulimin e të gjitha kërkesave të moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. DSID evidenton vazhdimisht nevojat që personeli akademik ka për pasurimin e fondit të bibliotekës përmes blerjeve ose huazimeve. Sipas informacionit për Bibliotekën e UAMD, vihet re se që prej vitit 2017 e më tej, nga ana e institucionit nuk është investuar në pasurimin e fondit të librave, por ky fond është pasuruar vetëm prej dhurimeve. Duke qenë se programi i studimit me karakter profesional “Teknikë Elektrikë” kërkon jo vetëm literaturë profesionale të përditësuar por edhe specifike, në formë manualesh teknike të instalimeve elektrike në sisteme të ndryshme teknologjike e shpërndarjeje ne TU dhe TM, del e nevojshme t’i jepet prioritet nga institucioni plotësimit të vazhdueshëm të literaturës me të rejat teknologjike që trajton ky program studimi. [EVIDENCA nr. 86 “Informacion për bibliotekën e UAMD”], [Vizita në institucion]
Kriteri 4. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Biblioteka e UAMD falë bashkëpunimeve është pjesë e platformës KOHA http://37.139.117.42:9800/ , databazë elektronike e krijuar nga vetë UAMD; dhe e platformës COBISS https://www.cobiss.net/al/http://plus.al.cobiss.net/opac7bib/search?db=udu duke krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. Prej vitit 2019, stafi akademik dhe studentët kanë akses on-line edhe në U-LIBRARY dhe në bashkëpunim me fondacionin AADF kanë akses në JSTOR deri në vitin 2023. [EVIDENCA nr. 88 “Të dhëna mbi materialet on-line që disponon Biblioteka e UAMD”], [Vizita në institucion]
Kriteri 5. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.	UAMD dhe DSID mundëson për studentët që biblioteka të jetë e pajisur me kompjutera, programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, internet, akses në libraritë online, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët dhe personelin akademik/ ndihmës akademik e administrativ. Funkcionimi i bibliotekës bëhet mbi bazën e një rregulloreje dhe orari të shpallur, për të cilën studentët kanë njoftim. [EVIDENCA nr. 89 “Grafik për funksionimin e Bibliotekës së UAMD në fundjavë” – UAMD], [Vizita në institucion]

Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	UAMD e ka rregulluar veprimtarinë e bibliotekës me rregullore të veçantë dhe ka përcaktuar në statut oraret e funksionimit të saj. Oraret e bibliotekës janë të shpallura në ambientet e UAMD dhe janë të mjaftueshme, pasi në 5 ditë të javës funksionon me dy turne dhe me 1 turn në ditët e shtuna dhe të diela . UAMD mundëson që gjatë sezonit të provimit orari i bibliotekës të zgjatet më tej, sipas kërkesës së studentëve. Ky orar u mundëson studentëve përdorimin e ambienteve të bibliotekës në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. [EVIDENCA nr. 89 “Grafik për funksionimin e Bibliotekës së UAMD në fundjavë” – UAMD], [EVIDENCA nr. 85 “Rregullore e Bibliotekës së UAMD”] [Vizita në institucion]
Kriteri 7. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.	Nga vizita në institucion u gjet se DSID bën përpjekje që biblioteka të raportojë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj. Në materialet që ndodhen në DVV del në dukje përpjekja që bëhet për pasurimin e bibliotekës me literaturë fizike të përditësuar por në 6 vitet e fundit, pasurimi i fondit është bërë kryesisht prej dhurimeve dhe jo me blerje nga institucioni sipas kërkesave të departamenteve. [Vizita në institucion], [EVIDENCA nr. 86 “Informacion për bibliotekën e UAMD”] [EVIDENCA nr. 90 “Korespondenca shkresore e bibliotekës me Rektoratin-Fakultetet-Personelin akademik për shtimin e zërave dhe përditësimin e fondit”] EVIDENCA nr. 56 “Lista e teksteve dhe cikleve të leksioneve të DSID që gjenden të depozituara në Bibliotekën e UAMD” EVIDENCA nr. 57 “Lista e teksteve dhe cikleve të leksioneve të DSID që gjenden të depozituara në format hard-copy në DSID”]
Konkluzione	<i>Personeli akademik i DSID që zhvillon lëndët në programin e studimit profesional “ Teknikë Elektrikë” ka vendosur në dispozicion të studentëve literaturë bazë dhe ndihmëse, që përcaktohet edhe në syllabuset përkatëse. Përveç teksteve mësimore në shqip , secili pedagog ka përgatitur leksione të shkruara (që i janë nënshtruar një reçence paraprake nga DSID) që iu jepen studentëve në formë elektronike ose kopje fizike, me qëllim garantimin e marrjes së dijeve dhe njohurive të nevojshme dhe të përditësuara, të parashikuara në programin e studimit.</i> <i>UAMD dhe DSID mundëson për studentët një bibliotekë të pajisur me kompjutera, programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, internet, akses pa pagesë në libraritë online, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët dhe personelin</i>

	<i>akademik/ndihmës akademik e administrativ. Funksionimi i bibliotekës bëhet mbi bazën e një rregulloreje dhe orari të shpallur, të mjaftueshëm dhe në përputhje me orarin e mësimi (funksionim në 7 ditë të javës), për të cilën studentët kanë njoftim. UAMD ka dokumentuar përpjekjen që bën për pasurimin e bibliotekës me literature fizike të përditësuar por duhet të parashikojë fond pasurimi edhe nga buxheti i institucionit dhe jo vetëm nga dhurimet, me qëllim përmbushje sa më të mirë të kërkesave të departamenteve për literaturë teknike të përshtatshme dhe të përditësuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.	DSID në FSP UAMD, shfrytëzon një sistem të menaxhimit të informacionit të brendshëm që ka lidhje me të gjitha aspektet e punës së institucionit: administrative, sekretaria mësimore, akademike. Kjo realizohet përmes platfotmës së menaxhimit të informatizuar që UAMD ka ndërtuar në nivel institucional përmes platformës softëare të sekretarisë ESSE3 nga RASH, nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit. [EVIDENCA nr. 91 “Rregullore e Sektorit të Komunikimit, ALUMNIT dhe Karrierës, Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike” EVIDENCA nr. 92 “Tabela me të dhënat e FSP për numrin e studentëve të regjistruar në programet 2- vjeçare të studimeve, Bachelor e Master Profesional, dhe të diplomuar për 5 vitet e fundit 2016-2021” EVIDENCA nr. 93 “Platforma softëare e sekretarisë ESSE3 e ofruar nga RASH”]
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi i brendshëm i menaxhimit që UAMD ka në përdorim, dhe administron : 1) informacionin në shërbim të studentëve për oraret e mësimi, bibliotekën, provimet etj 2) dokumentacionin (kopje fizike dhe digjitale), për aktivitetin akademik dhe për personelin akademik 3) aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, sekretarisë mësimore, personelit administrativ dhe partnerëve të

	angazhuar në realizimin e programit. Ka informacione në lidhje me projektet ku pedagogët mund të përfshihen etj. UAMD/FSP/DSID angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Strategjia e komunikimit në AUMD paraqet parimet , mekanizmat dhe pritshmëritë e institucionit në arritjen e objektivave akademikë. [Evidencë 95 “Strategjia e komunikimit e UAMD hartuar nga DASHA- Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike”
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i menaxhimit që UAMD përdor dhe platforma Pitagora, kanë qasje bazuar në përdorues/fjalëkalim, duke siguruar akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Aksesimi mbi informacionet e menaxhuara bazohet në privilegjet dhe hierarkinë e përdoruesve dhe vjen në formë të ndryshme me qëllim lehtësimin e komunikimit të pedagogëve me studentët dhe shkëmbimin e materialeve didaktike, detyra të studentëve etj. [EVIDENCA nr. 96 “Strategjia e TIK 2020-2025” EVIDENCA nr. 97 “Manual PITAGORA për pedagogët dhe studentët”]
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë formë të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit ka të integruar 2 platforma: Pitagora dhe Microsoft Teams si dhe modulet përkatëse që mundësojnë formë të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. Përmes këtyre platformave mund të zhvillohet mësim online, shkëmbime materialesh diaktike, dorëzime detyrash, informacion për orarin e mësimi, orarin e provimeve, rezultatet e provimeve etj. [EVIDENCA nr. 97 “Manual PITAGORA për pedagogët dhe studentët”]
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i integruar i menaxhimit që UAMD disponon, realizon monitorim në kohë reale të: 1) aktivitetit akademik në ndihmë të personelit akademik dhe studentëve me informacione në lidhje me procesin mësimor ; 2) aktivitetit administrativ në lidhje me sekretarinë mësimore dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për Departamentet dhe organet drejtuese. 3) Mbështetja e inovacionit në fushën e kërkimit shkencor dhe të mësimdhënies/mësimnxënies 4) Asistimi i komunitetit universitar, staf e studentë, që të përdorin në mënyrë efikase shërbimet në dispozicion 5) Siguria e gjithanshme e sistemeve dhe shërbimeve [EVIDENCA nr. 96 “Strategjia e TIK 2020-2025

	EVIDENCA nr. 97 "Manual PITAGORA për pedagogët dhe studentët"]			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.	UAMD ka në funksionim faqen zyrtare online https://uamd.edu.al/ Në këtë faqe gjenden informacione (në 2 gjuhë, njëra shqip) që lidhen me programin e studimit, personelin akademik të programit të studimit, aktivitetet e ndryshme studentore dhe akademike, struktura organizative e UAMD etj. Kjo faqe përditësohet dhe mirëmbahet sistematikisht sipas një politike menaxhuese të brendshme të institucionit. [EVIDENCA nr. 96 "Strategjia e TIK 2020-2025]			
Konkluzione	<i>UAMD disponon sistem të integruar të menaxhimit të informacionit të brendshëm që ka lidhje me të gjitha aspektet e punës së institucionit: administrative, sekretaria mësimore, akademike. Kjo realizohet përmes platfotmës së menaxhimit të informatizuar ESSE3 dhe Pitagora, nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit. Gjithashtu përmes platformës Microsoft Teams realizohet shkëmbim materialesh didaktike midis pedagogëve dhe studentëve, mësim online etj. Qasja në këto platforma bëhet me akses të dedikuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	UAMD harton një raport financiar të kostove në rang institucioni. Ky raport financiar nuk bëhet sipas njësisë bazë përgjegjëse për programet e studimit. Plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit bëhet gjithashtu mbi bazë institucioni për një cikël të plotë studimi dhe bazohet kryesisht tek tarifat e shkollimit, të ardhura nga projektet , nga donacionet e partnerëve dhe aktivitetet për të tretë. Të dhënat në lidhje me raportin financiar paraqiten në raportin vjetor. [EVIDENCA nr. 101 "Raport financiar i UAMD – Vendim BA nr. 5, nr. 174/4, datë 05.02.2021 për miratimin e detajimit të përdorimit të ardhurave të vitit 2021, për UAMD"]
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të	Plani i financimit hartohet mbi bazë institucioni dhe jo mbi bazë të njësisë bazë përgjegjëse për programet e studimit. Në këtë plan përfshihen kostot për financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 48

përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. Mbi bazën e këtij plani financimi dhe shpenzimeve përcaktohen edhe tarifat e shkollimit për çdo program studimi, të cilat raportohen në Raportin Vjetor të UAMD dhe publikohen në faqen zyrtare të internetit të UAMD. UAMD analizon dhe llogarit koston për UAMD si institucion dhe për secilin program studimi bazuar mbi metodologjinë e shpenzimeve në total: shpenzimet totale të Departamentit/numrin total të studentëve në program studimi. [Evidenca 112 Raporti vjetor UAMD 2022]
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	UAMD kryen dhe rregullon aktivitetin financiar përmes Zyrës së Financës dhe Administratorit të UAMD. Një strukturë e brendshme, Njësia e Auditit të Brendshëm kryen auditim periodik (çdo vit), vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të UAMD, mbi bazën e Kartës së NjAB në UAMD. [EVIDENCA nr. 103 “Tabela me kostot financiare të programit të studimit 2-vjeçar Teknikë Elektrike” Evidenca 104 Audit i brendshëm]
Kriteri 4. Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	UAMD raporton në nivel institucional në lidhje me aktivitetin financiar si dhe vlerësimin e qëndrueshmërisë financiare që ky institucion ka në lidhje me realizimin e programeve të studimit. Nëse i referohemi njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit “diplomë profesionale në Teknikë Elektrike” ka vështirësi për vlerësimin e realizimit të buxhetit të miratuar të vitit paraardhës dhe parashikimin për vitet në vijim, sepse ky program studimi ka zvogëlim të regjistrimeve të reja. Kjo e bën perspektivën e zhvillimit të këtij programi studimi të paqartë.
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	DSID ka punuar në drejtim të rritjes cilësore të infrastrukturës laboratorike me qëllim që studentët e programeve të studimit që ajo zhvillon të pajisen me dije dhe aftësi praktike për profesionin që duan të përvetësojnë. Kjo mundësohet prej UAMD që ka qëndrueshmërinë financiare të nevojshme për zhvillimin e programeve të studimit të DSID dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Nga ana e institucionit është investuar në një program studimi për të cilin tregu i punës ka nevojë të madhe, në një program studimi me infrastrukture të kompletuar dhe të përditësuar, me personel akademik me përvojë profesionale edhe në kushtet që numri i studentëve nuk ka qenë tepër i lartë. UAMD mund të kërkojë forma të tjera për promovimin e këtij programi studimi me qëllim tërheqjen e sa më shumë studentëve, të cilët duhet të jenë edhe me notë mesatare relativisht të lartë për shkak të nivelit të vështirësisë që

	ky program studimi ka. [Evidenca 112 Raporti vjetor UAMD 2022], [Vizita në institucion, takimi me Dekanin e e FSP në UAMD dhe Përgjegjësën e Departamentit DSID]			
Konkluzione	<i>UAMD harton një raport financiar vjetor të kostove në rang institucioni. Ky raport financiar nuk bëhet sipas njërive bazë përgjegjëse për programet e studimit. Plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit bëhet gjithashtu mbi bazë institucioni për një cikël të plotë studimi dhe bazohet kryesisht tek tarifat e shkollimit, të ardhura nga projektet , nga donacionet e partnerëve dhe aktivitetet për të tretë. Të dhënat në lidhje me raportin financiar paraqiten në raportin vjetor, raportohen në MAS dhe I nënshtrohen auditimit të brendshëm çdo vit .</i> <i>DSID ka punuar në drejtim të rritjes cilësore të infrastrukturës laboratorike. Kjo mundësohet prej UAMD që ka qëndrueshmërinë financiare të nevojshme për zhvillimin e programeve të studimit të DSID dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Mbetet shqetësues interesi i ulët që gjimnazistët/nxënësit e shkollave të mesme profesionale kanë për programin e studimit “diplomë profesionale në Teknikë Elektrikë”. Nga ana e institucionit është investuar në një program studimi për të cilin tregu i punës ka nevojë të madhe, në një program studimi me infrastrukturë të kompletuar dhe të përditësuar, me personel akademik me përvojë profesionale edhe në kushtet që numri I studentëve nuk ka qenë tepër I lartë . Mbetet të shikohen forma të tjera për promovimin e këtij programi studimi me qëllim tërheqjen e sa më shumë studentëve dhe me kualitet sa më të lartë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	UAMD ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Ky fakt evidentohet në Statutin e UAMD dhe rregulloren e programit të studimit “diplomë profesionale në Teknikë Elektrikë”. Gjatë vizitës në institucion, takimi me studentët konfirmoi se procedurat e ndjekura garantojnë barazinë, transparencën dhe të drejta të njëjta për të gjithë studentët, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre. [Vizita në UAMD Takimi me studentët], [Evidenca 18 Statuti i UAMD], [Evidence 28 Rregullorja e programit të studimit TE]
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Politikat dhe procedurat e pranimit, regjistrimit, mbështetjes me bursa, informimit të vazhdueshëm, vlerësimi dhe diplomimi garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Përcaktimi i kuotave dhe pranimi i studentëve bëhet sipas akteve ligjore në fuqi që njoftohen prej ministrisë përgjegjëse për arsimin, dhe akteve rregullatore të brendshme të UAMD. Pranimi bëhet pas aplikimit në portalin e Maturës Shtetërore U-Albania dhe shpalljes fitues prej UAMD të kandidatëve. Fituesit njoftohen në faqen zyrtare të internetit të UAMD. Duke qenë se programi i studimit “diplomë profesionale në Teknikë Elektrikë” është me natyrë profesionale, pranimi i kandidatëve nuk ka kufizime në lidhje me notën mesatare. Informimi në lidhje me koston e programit të studimit, përfitimin e bursave, në lidhje me programin e studimit etj jepet përmes takimeve të stafit me studentët, faqes së internetit dhe guidave studentore. Materialet didaktike u jepen studenteve në format elektronik në klasat digjitale përmes platformës Teams . [Vizita në institucion Takimi me studentët]. [https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/] [https://uamd.edu.al/ndihma-shoqerore-subvencione/]
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe	UAMD harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve, të cilat miratohen me Vendim Senati Akademik të UAMD dhe i njoftohen edhe ministrisë përgjegjëse për arsimin. UAMD bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Regjistrimi i studentëve të pranuar në UAMD bëhet pasi ata dorëzojnë dokumentacionin që vërteton plotësimin e kushteve shpallur në faqen zyrtare të UAMD.

udhëzimeve përkatëse.	Në takimin me sekretarinë mësimore u verifikua se në dosjen e studentëve ndodhen dokumentat e përcaktuara në rregulloren e programit të studimit TE dhe statutin e UAMD. [EVIDENCA nr. 105 "Praktika shkresore MAS-UAMD-FSP për publikimin e kriterëve dhe kuotave të pranimit të studentëve për vitin 2021-2022"], [Evidenca 18 Statuti i UAMD], [Evidence 28 Rregullorja e programit të studimit TE]
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	UAMD ka publikuar në faqen zyrtare të tij në internet Statutin e UAMD dhe Rregulloren e Programit të Studimit TE ku tregohen qartë kriteret dhe procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve. Kandidatët studentë të interesuar mund të gjejnë informacion edhe për mundësitë e përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit të studimeve, njohjes së kurseve profesionale të kryera më parë, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit. Ky informacion është i kuptueshëm dhe i aksesueshëm nga publiku. Për studentët që regjistrohen ose transferohen në programin e studimit Teknikë Elektrike, komisioni ad-hoc i ekuivalentimit, mbi bazën e dokumentacionit që dërgon Universiteti dërgues, përcakton detyrimet që do të ketë studenti, nëse pranohet në atë program studimi, duke u bazuar në planin mësimor në fuqi si dhe në njohjen e lëndëve ekuivalente të shlyera. Gjithashtu, UAMD javën e parë të semestrit të parë e përdor për informimin e detajuar të studentëve të regjistruar, njohjen me stafin akademik, ambientet etj. [Evidence 107 Java e orientimit të studentëve] [Evidenca 18 Statuti i UAMD], [Evidence 28 Rregullorja e programit të studimit TE]
Kriteri 5. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	UAMD ka parashikuar në Statutin e UAMD, Neni 6, pika 2 (b), kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Në lidhje me kandidatët student me aftësi të kufizuara, UAMD ka ndërtuar infrastrukturë që lehtëson aksesimin e të gjitha ambienteve mësimore e shërbimeve për të gjitha kategoritë. [Evidenca 18 Statuti i KPT], EVIDENCA nr. 106 "Rregullore për trajtimin e studentëve me aftësi të kufizuara në UAMD" [Vizita në institucion, ambientet]
Kriteri 6. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UAMD ka hartuar dhe zbaton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e studentëve të pranuar në programe studimi me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. Bursat ofrohen për studentët me notë mesatare të lartë (mbi 9) në hyrje dhe/ ose gjatë zhvillimit të studimeve. Sipas raportit vjetor, në UAMD nuk ka patur asnjë student që plotësonte kushtin e përfitimit të bursës në programin e studimit me karakter profesional Teknikë Elektrike. [Vizita në institucion Takimi me studentët], [https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/]

	https://uamd.edu.al/ndihma-shoqerore-subvencione/			
Konkluzione	UAMD ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore, që garantojnë barazinë, transparencën dhe të drejta të njehta për të gjithë studentët, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre. UAMD ka parashikuar në Statutin e tij kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Në lidhje me kandidatët student me aftësi të kufizuara, UAMD ka ndërtuar infrastrukture që lehtëson aksesimin e të gjitha ambienteve mësimore e shërbimeve për të gjitha kategoritë. UAMD ka hartuar dhe zbaton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e studentëve të pranuar në programe studimi me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. Bursat ofrohen për studentët me notë mesatare të lartë (mbi 9) në hyrje dhe/ose gjatë zhvillimit të studimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	UAMD ka vlerësuar me rëndësi të madhe vënien në dispozicion të studentëve të vet dhe kandidatëve për student informacion të plotë në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion ofrohet në mënyra të ndryshme. Kryesisht ky informacion u jepet studentëve nga zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës gjatë javës informuese në semestrin I, viti I, si dhe nga secili pedagog që zhvillon lëndët e programit të studimit. Këto kritere e procedura gjenden edhe në Statutin e UAMD dhe rregulloren e programit të studimit. Gjithashtu UAMD përdor platformën e sistemit të brendshëm të informimit për shkëmbim informacionesh të ndryshme midis studentëve dhe personelit akademik/sekretarisë mësimore. Në faqen zyrtare të UAMD ka të dhëna për programet e studimit, kriteret dhe procedurat e pranimit dhe regjistrimit, tarifat e shkollimit, aksesimi në Libraritë online etj. [Evidencë 18 Statuti i UAMD], [Evidencë 28 Rregullorja e programit të studimit], [https://uamd.edu.al/fakulteti-i-studimeve-profesionale/]
Kriteri 2. Institucioni informon	UAMD i ka të parashikuara në Statutin e tij dhe Rregulloren e

studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.	Programit të studimit kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme. Ky informacion iu jepet studentëve të interesuar gjatë parashtrimit të ofertës akademike nga Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës dhe pasqyrohet edhe në kontratën që nënshkruhet nga UAMD dhe studenti në momentin e regjistrimit. Gjatë takimit me studentët u konfirmua se nga ana e UAMD ka gadishmëri për dhënie informacioni të plotë në lidhje me këtë çështje. [Evidencë 18 Statuti i UAMD], [Evidencë 28 Rregullorja e programit të studimit TE], [Vizita në institucion, takimi me studentët]
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	UAMD i ka të parashikuara në Statutin e tij dhe Rregulloren e Programit të studimit TE kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. Ky informacion, i detajuar u jepet studentëve në javën e parë të mesimit të çdo lënde, sëbashku me informacionin që përmban syllabusi përkatës. Studentët konfirmuan që kishin informacion të plotë në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve, mënyrën e zgjidhjes së ankesave të studentëve për vlerësimin etj. [Evidencë 126 Syllabuset], [Evidencë 28 Rregullorja e programit të studimit TE]
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.	UAMD ka të parashikuara në Statutin e tij dhe Rregulloren e Programit të studimit TE kriteret dhe procedurat për kryerjen e punimit përfundimtar prej studentit dhe diplomimin e tij. Përmes tutoriateve, postës elektronike, njoftimeve në ambientet e institucionit, UAMD informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit, të cilat miratohen nga Senati Akademik i UAMD për çdo vit, që mund të jetë një temë diplome ose një provim përfundimtar, në varësi të notës mesatare të dy viteve të studimit. Pas kryerjes së detyrimit përfundimtar me një nga format e miratuara, studenti pajiset me diplomë sipas formatit të aprovuar nga QSHA. [Evidencë 28 Rregullorja e programit të studimit në TE], [Evidencë 10 Modeli i diplomës, Miratimi nga QSHA]
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Nga takimi me Rektorin/Përgjegjësin e Departamentit, u konfirmua se përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, UAMD 1) publikon udhëzues të posaçëm në formë fletëpalosjesh ose broshurash tek faqja zyrtare e UAMD për informacion më të detajuar 2) organizon takime të hapura dhe vizita në UAMD për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit, gjatë Javës së informimit. 3) organizon panaire/ëorkshope pune dhe studimi 4) organizon ture në gjimnazet e shkollat e mesme për promovimin

	e programit të studimit. Etj. Pavarësisht përpjekjeve që UAMD bën për promovimin e programit të studimit Diplomë profesionale në TE, ky program studimi ka pak studentë të regjistruar. Ky fakt bën domosdoshmëri përpjekjen e UAMD në drejtime të tjera, duke kërkuar ndihmë nga ministria përgjegjëse për arsimin, por edhe ajo e mbështetjes sociale apo instanca të tjera ligjore, për ndryshime të mundshme ligjore që do e bënin më tërheqës dhe të vlerësuar këtë program studimi që përgatit një profesionist për të cilin tregu i punës ka shumë nevojë. [Evidencë 72 Leksione të hapura dhe Ëorkshop me studentë], [Evidencë 95 Strategjia e komunikimit në UAMD], [Evidence 107 Java e orientimit],			
Konkluzione	<i>UAMD ka vënë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Diplomë Profesionale në TE informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen e rezultateve akademike në programe të mëparshme studimi, kriteret e procedurat për vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit, organizon takime të hapura në ambientet e UAMD dhe ëorkshope për promovimin e programit të studimit. Ky informacion jepet përmes zyrës së Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, Sistemit të brendshëm të informimit, Platformës ESSE3, nga personeli akademik, nga njoftimet në faqen zyrtare dhe njoftimeve në ambientet e UAMD, në javën e informimit dhe turet në UAMD etj. Mbetet të kërkojen forma të tjera promovimi të këtij programi studimi, sepse studentët e regjistruar janë në rënie..</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Studentët e programit të studimit Diplomë Profesionale në Teknikë Elektrik, gjatë vizitës në institucion pranuan se janë informuar në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Ky informacion gjendet në faqen zyrtare të UAMD https://uamd.edu.al Këtu mund të gjendet informacion edhe për pranimin, regjistrimin, tarifat e shkollimit, mundësitë e punësimit etj. Këto informacione janë pasqyrim i Vendimeve të Senatit të UAMD mbështetur në Udhëzimet

	e ministrisë përgjegjëse për arsimin. [EVIDENCA nr. 28 “Rregulloret e programit të studimit “Teknikë Elektrike”, Kreu III Organizimi i studimeve në programin 2-vjeçar TE neni 21 Struktura e programit të studimit “Teknikë Elektrike”, neni 27 Kohëzgjatja e studimeve etj]
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	UAMD informon studentin në lidhjen me aktivitetet mësimore, kurrikulat dhe jetën studentore sipas fakulteteve, departamenteve dhe programeve të studimit . Gjithashtu, përmes aksesimit në Sistemin e brendshëm të informimit UAMD ka vënë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion në formën e udhëzuesve të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Ky informacion shpjegohet edhe prej personelit akademik respektiv, me qëllim që të kuptohet më mirë prej studentëve. Përmes këtij sistemi studenti merr info edhe për oraret e veprimtarive mësimore, rezultateve akademike, detyrimeve, formularë të ndryshëm, etj [Evidencë 93 Platforma e sekretarisë ESSE3 RASH], https://uamd.edu.al/teknik-elektrik/
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Në faqen zyrtare të UAMD ka informacion për studentët mbi mundësitë e punësimit. Panairët e punës dhe studimit që UAMD organizon periodikisht, ofrojnë mbështetjen institucionale për orientimin e studentëve drejt dhe në tregun e punës. Gjithashtu, Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, në bashkëpunim me Departamentin DSID organizon takime me bizneset dhe praktikantët mësimore të studentëve tek partnerët dhe bizneset me të cilat ka kontrata e marrëveshje bashkëpunimi dhe përpunet të krijojë ura bashkëpunimi në shërbim të punësimit të tyre menjëherë pas përfundimit të studimeve dhe në përputhje me diplomën. Tregohet kujdes që njoftimet e punësimit të bëhen të dukshme në forma të ndryshme: në faqen zyrtare të UAMD, në rrjetat sociale të UAMD, në këndin e njoftimeve në UAMD dhe në email-et e studentëve. Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës ka krijuar një bazë të dhënash në lidhje me informacionin për çdo student: arritjet akademike, punësimin, ecurinë e karrierës, përmes lidhjeve të vazhdueshme me ta, edhe pas diplomimit. https://www.uamd.edu.al/ep-content/uploads/2022/07/UAMD-Udhëzues-nga-Qendra-e-Karrierës-dhe-Alumni-21-Maj-2020.pdf [EVIDENCA nr. 108 “Udhëzues nga zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës për punë” EVIDENCA nr. 109 “Shoqata ALUNMI e studentëve të UAMD”]
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në	Studentëve që pranohen dhe regjistrohen në programin e studimit Diplomë Profesionale në Teknikë Elektrike iu vihet në dispozicion përmes Sistemit të brendshëm të informimit një informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Pjesë e këtij informacioni gjendet edhe në faqen zyrtare të internetit të UAMD. Gjithashtu, secili anëtar i personelit akademik

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 56

funksion të realizimit të tij.	informon në kohën e duhur studentët për procesin mësimor, labororet dhe ambientet e tjera në shërbim të procesit mësimor. [Evidenca 126 Syllabuset] [Evidencë 107, Java e orientimit të studentëve]			
Kriteri 5. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Studentët në UAMD informohen prej Zyrës së Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit. Ky informacion jepet në kohë /etapa të ndryshme të ecurisë së tyre: në hyrje gjatë javës së Informimit dhe në prag të praktikës profesionale, ku njihen me partnerët dhe institucionet bashkëpunuese të UAMD, ku parashikohen të realizohen praktikat profesionale, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës. Studentët njoftohen vazhdimisht, përmes mjeteve të ndryshme, në lidhje me ofertat e punës, sipas specialiteteve. [Evidenca 29 Marrëveshje të FSP me IAL], [Evidenca 31-37 Marrëveshje me biznese]			
Konkluzione	<i>UAMD ka vënë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit. Ky informacion u jepet studentëve në etapa të ndryshme të ecurisë së tyre përmes formave të ndryshme të komunikimit: Sistemi i brendshëm i informimit, java e orientimit, takime me biznese, njoftimet e punësimit etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	DSID në zbatim të Statutit të UAMD ka ngritur strukturën e nevojshme, me detyra të përcaktuara qartë me qëllim sigurimin e statistikave vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit Diplomë Profesionale në Teknikë Elektrike, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Për këtë angazhohen zyrat e Sekretarisë Mësimore, Protokoll-Arshiva, Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyra e Financës, Zyra IT. Zyra IT kujdeset që të krijojë, ruajë dhe administrojë kopjen elektronike të dokumentacionit "letër" që krijojnë gjithë zyrat e tjera.


	UAMD bazuar në Udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin, dokumenton të dhënat për studentët, të dhënat për rezultatet e arritjeve akademike të studentëve dhe rezultatet e diplomimit. Në regjistrat bazë evidentohen për çdo student të regjistruar numrat vetjakë të matrikullimit, të dhëna personale, etj. Këtu pasqyrohen edhe të dhënat për studentët e transferuar apo ç’regjistruar. Në regjistrin e arttjeve akademike evidentohen notat për çdo lëndë të fituar, ndërsa në regjistrat e diplomimit evidentohen të dhënat për diplomën e çdo studenti të diplomuar, për çdo program studimi. Dokumentacioni mbahet konform përcaktimeve ligjore. [Evidenca 92, Tabela me të dhënat e FSP për numrin e studentëve të regjistruar në programet 2- vjeçare të studimeve, Bachelor e Master Profesional, të diplomuar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të viteve akademike 2016-2022]
Kriteri 2. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit që UAMD ka ngritur dhe përdor mbi bazën e platformës ESSE3 nga RASH, për menaxhim të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshëm dhe nga personat e autorizuar për të gjithë informacionin në lidhje me studentët. Sistemi mundëson edhe gjenerimin e raporteve të ndryshme sipas kërkesave nga Sekretaria Mësimore dhe Zyra e Financës. [Evidence 93, Platforma e sekretarisë ESSE3 RASH]
Kriteri 3. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Mbështetur në Statutin e UAMD, Neni 24, është ngritur NjSBC si strukturë të përhershme autonome në nivel institucioni e cila bën kontrollin periodik të përvitshëm të sekretarisë mësimore, sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit, dhe vlerëson e dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, procesin mësimor dhe veprimtaritë e tjera në funksion të programit të studimit. NjSBC përbëhet nga përfaqësues prej të gjithë departamenteve, një përfaqësues i jashtëm dhe një student. NjSBC ka akses në të gjithë informacionin që ka lidhje me studentët, personelin akademik, veprimtarinë e departamenteve, sekretarisë mësimore etj. NjSBC angazhohet në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit përmes rishikimit të vazhdueshëm të syllabuseve, monitorimin e aktivitetit mësimor, kontrollin e vazhdueshëm të pedagogëve të rinj prej atyre me eksperiencë, monitoron rezultatet e sondazheve të studentëve për personelin akademik, nxjerr raporte të ndryshme vlerësimi : raportin vjetor të NjSBC, raportin për cilësinë e studentëve në hyrje dhe përfundim të studimeve etj. [EVIDENCA nr. 112 “Raporti vjetor i UAMD për vitin 2018-2019]
Kriteri 4. Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike	DSID në UAMD, përgjegjëse për programin e studimit Diplomë Profesionale në Teknikë Elektrikë, harton raporte analitike, periodike 1-vjeçare ku përveç të tjerave analizon profilin dhe cilësinë në hyrje

mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	dhe dalje të studentëve, shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, përqindje e punësimit në përshtatje me diplomën etj. Këtyj informacioni i bashkëngjitet edhe një propozim me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Ky raport është pjesë e raportit vjetor që UAMD dorëzon çdo vit në ministrinë përgjegjëse për arsimin në lidhje me ecurinë e të gjitha programeve të studimit që UAMD zhvillon. [EVIDENCA nr. 133 "Raportet e analizës vjetore të DSID për vitet 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021" EVIDENCA nr. 136 "Raporti vjetor i FSP për vitin 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021" EVIDENCA nr. 112 "Raporti vjetor i UAMD për vitin 2018-2019, pika 1.5 Standartet dhe cilësia"]			
Konkluzione	Në zbatim të Statutit, në përmbushje të misionit dhe objektivave të UAMD, është ngritur një strukturë akademike – administrative që mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Këto të dhëna ruhen si dokumenta në "letër" pranë zyrave përkatëse dhe Protokoll-Arshivës si dhe në formë elektronike në Sistemin e brendshëm të informacionit. Dokumentacioni që ka lidhje me studentët (të dhëna personale, arritjet akademike dhe diplomimi) ruhen në regjistra sipas udhëzimeve të MAS, konform akteve rregullatore të brendshme dhe në përputhje me ligjet në fuqi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	UAMD ka parashikuar në Statutin e tij përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese si Senati Akademik, NjSBC etj. Sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit, Statuti UAMD Neni 89, pika c, dhe Neni 90, studentët kanë të drejtë vendimarrje përmes përfaqësuesve të tyre në të gjitha nivelet. Çdo dy vite zgjidhet Këshilli Studentor i UAMD me përfaqësues studentësh nga çdo program studimi dhe çdo vit akademik. Përbërja e Këshillit Studentor dhe aktivitetet që ai zhvillon paraqiten në faqen zyrtare të internetit. Nga takimi me studentët gjatë vizitës në institucion, u konfirmua përfshirja e tyre në vendimarrje, në të gjitha instancat që parashikojnë aktet e

	brendshme rregullatore në UAMD. [Evidencë 18 Statuti i UAMD miratuar me Urdhërin nr. 385 datë 09.07.2018 të MASR, Neni 90 Këshillat e studentëve"], [Vizita në institucion, takim me studentët e programit të studimit]
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	UAMD inkurajon një jetë studentore sa më aktive duke i përfshirë studentët dhe/ose përfaqësuesit e tyre në : 1) vendimmarrje, përmes përfaqësimit të studentëve në Senatin Akademik 2) këshillim në lidhje me përmirësimin e procesit mësimor dhe shërbimeve në UAMD 3) vlerësimin periodik mbi procesin akademik, përmes sondazheve sistematike që UAMD zhvillon. Kjo përfshirje e studentëve është reale, prek aspekte konkrete, prej studentëve konsiderohet frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. [Vizita në institucion, takim me studentët e programit të studimit] [https://www.uamd.edu.al/ëp-content/uploads/2022/07/UAMD-Udhezues-nga-Qendra-e-Karrieres-dhe-Alumni-21-Maj-2020.pdf].
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	DSID, si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Diplomë Profesionale në Teknikë Elektrike, përfshin studentët në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë periodikë, focus grupe, etj, duke parashikuar procedura joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme. FSP/DSID garanton përfshirjen e studentëve dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi. Çdo personel akademik në fund të lëndës semestrale mbledh mendime dhe sugjerime nga studentët dhe i parashtron në mbledhjen e posaçme të departamentit. [Vizita në institucion, takim me studentët e programit të studimit], [EVIDENCA nr. 28 “Rregullore e e programit të studimit “Teknikë Elektrike”, Kreu III Organizimi i studimeve në programin 2-vjeçar TE neni 26 Transferimi i studimeve, njohja dhe njesimi i diplomave” EVIDENCA nr. 11 “Urdhër i Dekanit të Fakultetit të Studimeve Profesionale nr. 31, nr. 396/2 prot., datë 21.12.2021 për ngritjen e GVB për departamentet e FSP” EVIDENCA nr. 114 “Pyetsor i hartuar nga DSID për marrjen e mendimeve të studentëve lidhur me përmirësimit të programit të studimit”
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit	Studentëve në UAMD, në programin e studimit Diplomë profesionale në Teknikë Elektrike iu jepet mundësia të shprehin mendimin mbi parimin e barazisë dhe ndershmërisë në kryerjen e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, Studentët, bazuar në Rregulloren e

dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Programit të Studimit kanë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. Takimi me studentët në institucion e konfirmoi këtë. [EVIDENCA nr. 28 “Rregullore e e programit të studimit “Teknikë Elektrike”.], [Takimi me studentët në institucion]			
Konkluzione	<i>UAMD dhe DSID bazuar në aktet e brendshme rregullatore si Statuti dhe Rregullorja e PS,përfshin dhe angazhon studentët në:</i> <i>1) organet vendimmarrëse e këshilluese, si Senati Akademik, NjSBC,Këshilli Studentor</i> <i>2) në veprimtaritë që DSID kryen në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit,</i> <i>3) Në diskutimet në Departament për përmirësimin e metodave të mësimdhënies</i> <i>4) Në focus grupe, tutoriate sondazhe periodike për diskutimin e mundësive të rritjes së cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	UAMD në aktet e brendshme rregullatore ka sanksionuar procedura dhe ka ngritur njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës në varësi të Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike angazhohet për orientimin e studentëve në javën e parë të hyrjes në UAMD, i pajis me email zyrtar në UAMD dhe informacione të nevojshme për jetën studentore. Gjatë viteve të zhvillimit të programit të studimit, Departamenti DSID angazhohet përmes personelit akademik në informimin e vazhdueshëm të studentëve, sipas fazës që ata kanë arritur në këtë zhvillim. Nga ana e studentëve u konfirmua prezenca informuese e strukturave në UAMD në ndihmë të programit të studimit. [EVIDENCA nr. 91 “Rregullore e Sektorit të Komunikimit, ALUMNIT dhe Karrierës, Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike”; Vizita në institucion, takimi me studentët e PS]
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem	UAMD ka ngritur dhe ka bërë funksional në nivel institucioni një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit

të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, siç janë Sekretaria Mësimore, Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës që jep një ndihmesë më të profilizuar për studentët e programit të studimit. [EVIDENCA nr. 116 “Studentë të trajnuar nga Zyra e Karrierës”]			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	UAMD iu ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës përmes Zyrës së Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, që ka si qëllim: 1) këshillimin e karrierës 2) mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, në ambiente të dedikuara dhe orar pritjeje e person kontakti 3) jep informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, 4) ndihmon studentët në zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. [EVIDENCA nr. 108 “Udhëzues nga Zyra e Komunikimit, ALUMNIT dhe Karrierës, Aplikojmë për punë, 2020”]			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Një nga detyrat e Zyrës së Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës është të ndjekë studentët pas diplomimit, të mbledhë, të përpunojë dhe të mbajë të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. Kjo zyrë synon të krijojë lidhje bashkëpunimi të qëndrueshme me bizneset e fushës në tregun e punës me qëllim lehtësimin e punësimit të tyre. Njoftimet e punësimit janë të vazhdueshme dhe iu bëhen të ditura studentëve në forma të ndryshme. [EVIDENCA nr. 117 “Databaze e punësimit të alumni”]			
Konkluzione	UAMD ka ngritur strukturë të dedikuar dhe ka hartuar procedura specifike për pritjen e studentëve, orientimin e tyre gjatë javës së parë në UAMD, këshillimin e vazhdueshëm të studentëve përmes koordinatoreve të PS dhe Zyrës së Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, menaxhimin e ankimeve e problematikave gjatë procesit mësimor, etj. Kjo strukturë ushtron veprimtarinë në mënyrë të përhershme dhe është lehtësisht e arritshme nga studentët, me zyrë të dedikuar, personel përgjegjës dhe orare të afishuara.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në “Teknikë Elektrike” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Pikat e forta dhe afirmime:

1. UAMD ka ngritur strukturë të dedikuar dhe ka hartuar procedura specifike për pritjen e studentëve, orientimin e tyre gjatë javës së parë në UAMD, këshillimin e vazhdueshëm të studentëve përmes koordinatorëve të Programit të Studimit dhe Zyrës së Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, menaxhimin e ankimimeve e problematikave gjatë procesit mësimor, etj.
2. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka kualifikimin e duhur për këtë program studimi dhe bën përpjekje të vazhdueshme për ngritjen profesionale. UAMD dëshmon një qëndrueshmëri në përbërjen e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit me karakter profesional në “ Teknikë Elektrikë”, pasi vihet re se stafi akademik efektiv ka ndryshime të vogla dhe ato janë kryesisht për shkak të zvogëlimit të numrit të studentëve që ndjekin këtë program studimi.
3. UAMD ka vënë në dispozicion të programeve të studimit që zhvillon, mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore nga ana logjistike.
4. UAMD ka bashkëpunime me IAL brenda dhe jashtë vendit ku janë të përfshirë dhe personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.

Pika të dobta:

1. Numri i laboratorëve për këtë program studimi është i ulët, duke patur parasysh që është program studimi me karakter profesional dhe praktik. **(Standardi II.2, kriteri 2)**
2. Biblioteka ka një numër të kufizuar tekste mësimore dhe manual të dedikuara për këtë program studimi. **(Standardi IV.3)**
3. Rezultatet e arritura nga praktika profesionale duhet të analizohen nga UAMD për të rritur nivelin e realizimit të tyre, i cili është shumë i rëndësishëm për aftësitë praktike të studentëve, që ndjekin këtë program studimi. **(Standardi I.2, kriteri 4)**

Rekomandime:

1. Të shikohen forma të tjera për promovimin e këtij programi studimi me qëllim tërheqjen e sa më shumë studentëve dhe me cilësi më të lartë, pasi ka interesi të ulët nga gjimnazistët/nxënësit e shkollave të mesme profesionale për këtë program studimi.
2. Biblioteka e IAL duhet të pajiset me tekste mësimore, manuale teknike dhe libra dedikuar këtij program studimi
3. Duhet të rritet numri i laboratorëve dhe pajisja e tyre për rritjen aftësive praktike të studentëve, të cilët ndjekin këtë program studimi.



4. Duhet të rritet më tej bashkëpunimi me kompanitë e sektorit për një praktikë profesionale, që ti shërbej më shumë studentëve dhe punësimit të tyre të menjëhershëm.
5. UAMD duhet të angazhoj personel ndihmës-akademik, laborant të dedikuar për këtë program studimi pasi mungonte.



Evaluation's conclusions for the professional study program "Electrical Technic" provided by the Higher Education Institution "Aleksandër Moisiu" University, Durrës

Strengths and affirmations:


1. UAMD has established a dedicated structure and has drawn up specific procedures for the reception of students, their orientation during the first week at UAMD, the continuous counseling of students through the coordinators of the Study Program and the Office of Communication, Alumni and Career, the management of complaints of problems during the teaching process, etc.
2. The academic staff engaged in this study program has the appropriate qualification for this study program and makes continuous efforts for professional development. UAMD demonstrates a stability in the composition of the academic staff engaged in the study program with a professional character in "Electrical Engineering", as it is noted that the effective academic staff has small changes and they are mainly due to the reduction in the number of students attending this study program.
3. UAMD has made available to the study program it develops sufficient and suitable environments for the development of educational activity from the logistical point of view.
4. UAMD has collaborations with HEIs inside and outside the country where the academic staff engaged in this study program are also involved.

Weaknesses:

1. The number of laboratories for this study program is low, considering that it is a study program with a professional and practical character.
2. The library has a limited number of textbooks and manuals dedicated to this study program.
3. The results achieved by professional practice should be analyzed by UAMD to increase the level of their realization, which is very important for the practical skills of students who follow this study program.

Recommendation:

1. To look at other forms for the promotion of this study program in order to attract as many students as possible and of higher quality, since there is low interest from high school students/students of vocational secondary schools for this study program.
2. The HEI library should be equipped with textbooks, technical manuals and books dedicated to this study program
3. The number of laboratories and their equipment should be increased in order to improve the practical skills of students who follow this study program.
4. Cooperation with the companies of the sector should be further increased for a professional practice, to serve more students and their immediate employment.
5. UAMD should engage academic support personnel, dedicated laboratory staff for this study program since it was missing.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X